



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

# RAPORT MBI PROCESIN E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

*(Periudha raportuese: viti 2023)*

Janar 2024

**PASQYRA E LËNDËS**

<b>HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>PJESA I: NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EVROPIAN .....</b>	<b>4</b>
1.1 PËRMBLEDHJE E ECURISË SË PROCESIT TË NEGOCIATAVE .....	4
1.2 INTEGRIMI I PËRSHPEJTUAR .....	8
1.3 INTEGRIMI EVROPIAN NË NIVEL VENDOR .....	12
<b>PJESA II: PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN .....</b>	<b>20</b>
<b>PJESA III: MENAXHIMI I FONDEVE NGA BASHKIMI EVROPIAN DHE DONATORË TË TJERË .....</b>	<b>50</b>

## HYRJJE

Raporti i Këshillit të Ministrave për “Procesin e Integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, hartohet në zbatim të nenit 18, të ligjit nr.19/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian””, i cili përcakton në pikën 1: “Këshilli i Ministrave, deri më 31 janar të çdo viti, paraqet në Kuvend një raport të detajuar mbi zbatimin e detyrimeve, sipas Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim dhe menaxhimin e fondeve nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë, për vitin paraardhës”.

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian mbetet objektivi kryesor strategjik i Republikës së Shqipërisë. Qeveria shqiptare në programin e saj qeverisë ka përcaktuar se “Evropa e Bashkuar është busulla jonë dhe familja natyrale të cilës i përkasim, por ku ende mungojmë”.<sup>1</sup>

Zhvillimi i Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022, shënoi fillimin zyrtar të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hapja e negociatave mbi bazë merite ishte një arritje historike për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë ajo shënoi edhe fillimin e një procesi transformues të gjithanshëm për Shqipërinë.

Procesi i negociatave dhe, më pas, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, do të mbështesë më tej demokratizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, do të nxisë konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve reformuese, duke përsheptuar zhvillimin ekonomik dhe përfaqsimin me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Ky Raport paraqet progresin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, ecurinë e procesit të bisedimeve për anëtarësim, si dhe menaxhimin e fondeve nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë, për vitin 2023 në përputhje me angazhimet e vendit sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në kuadër të procesit të negociatave dhe integritit, Paketës së Zgjerimit të Komisionit Evropian<sup>2</sup>, vizionit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030, si dhe me programin e Qeverisë shqiptare 2021 – 2024.

Ky raport është hartuar nga Departamenti i Politikës dhe Integritit Evropian në Kryeministri, në rolin e Sekretariatit të Përgjithshëm të Integritit Evropian, nën drejtimin e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, në bashkëpunim me negociatorët për çdo kapitull e kriter dhe 36 sekretariatet e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës të Integritit Evropian (GNPIE) për çdo grupkapitull/kapitull dhe kriter të acquis të Bashkimit Evropian, si dhe Agjencinë Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), përgjegjëse për koordinimin e fondeve nga Bashkimi Evropian dhe donatorëve të tjerë.

---

<sup>1</sup> [https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi\\_Qeverises\\_2021-2025.pdf](https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf)

<sup>2</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_22\\_6082](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_6082)

## **PJESA I: NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EVROPIAN**

### 1.1 Procesi i negociatave

Hapja e negociatave mbi bazë merite ishte një arritje historike për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë ajo shënoi edhe fillimin e një procesi transformues të gjithanshëm për Shqipërinë.

Menjëherë pas Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 15 shtator 2022, filloi procesi i shqyrtimit analitik të *acquis* (*screening*), si hapi i parë i negociatave të anëtarësimit, i cili u finalizua në nëntor të vitit 2023. Procesi i shqyrtimit kryhet së bashku me Komisionin Evropian dhe i lejon vendit kandidat të familjarizohet me *acquis* dhe, më pas, të tregojë nivelin e përafrimit me legjislacionin e BE-së, si dhe të përvijojë planet për përafrimin e mëtejshëm.

Procesi *screening* u zhvillua në 2 faza:

- i) **takimet shpjeguese** – (nga viti 2019 deri në vitin 2023) ku shërbimet e Komisionit Evropian paraqitën zhvillimet e legjislacionit dhe politikave të Bashkimit Evropian dhe
- ii) **takimet bilaterale** – ku pala shqiptare analizoi dhe paraqiti situatën aktuale ku ndodhet vendi përkundrejt kërkesave të *acquis* së BE-së, përmes prezantimeve për çështje të ndryshme sipas kapitujve & nënkapitujve.

Në përputhje me metodologjinë e re të zgjerimit (2020), negociatat zhvillohen bazuar në 6 (gjashtë) grupime kapitujsh: grupimi i parë “Themeloret”, grupimi i dytë “Tregu i brendshëm”, grupimii tretë “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse”, grupimi i katërt “Agjenda e gjelbër dhe ndërlidhja e qëndrueshme”, grupimi i pestë “Burimet, bujqësia dhe kohezioni”, grupimi i gjashtë “Marrëdhëniet e jashtme”.

Hapja e negociatave bëhet sipas grupimeve (të gjithë kapitujt/kriteret e një grupimi plotësohen për hapjen në të njëjtën kohë), ndërkohë që mbyllja bëhet individualisht për çdo kapitull/kriter. Grupimi i kapitujve mbyllet kur çdo kapitull i tij është mbyllur paraprakisht.

Në përputhje me metodologjinë e Bashkimit Evropian, grupimi i parë “Themeloret” është grupimi që hapet i pari dhe mbyllet i fundit, pasi Shqipëria ka përmbushur të gjitha kriteret e anëtarësimit në Bashkimit Evropian në të gjithë grupimet e kapitujve të tjerë & kriteret.

Në zbatim të metodologjisë për anëtarësim, Shqipëria shënoi një tjetër hap shumë të rëndësishëm në procesin e integritit në Bashkimin Evropian. Procesi i shqyrtimit analitik të përputhshmërisë së legjislacionit & politikës tonë me atë të Bashkimit Evropian, i njohur si “*screening*” përfundoi me sukses në muajin nëntor 2023 në Bruksel me vlerësime për ekipet shqiptare nga Komisioni dhe Parlamenti Evropian, specifikisht:

- Komisioneri për Zgjerimin dhe Fqinjësinë e Mirë, z. Oliver Varhelyi në deklaratën e tij në korrik 2023, gjatë vizitës së tij zyrtare në Tiranë, ka shprehur vlerësimet lidhur me procesin *screening*, ku ai ka thënë në deklaratën publike se ‘*delegacionet nga Shqipëria kanë ardhur shumë mirë të përgatitur dhe kanë qenë të angazhuar aktivisht në diskutimet përgjatë procesit screening të negociatave*’.

- Presidentja e Komisionit Evropian Ursula Von der Leyen në deklaratën e saj në kuadër të Samitit të Procesit të Berlinit, të mbajtur në Tiranë në tetor 2023, është shprehur se *‘procesi i shqyrtimit, po ecën pa probleme. Shumë falenderuese për ekipet negociuese nga të dyja palët. Ata po bëjnë një punë fantastike’*.
- Raporti 2023 i Komisionit Evropian për Shqipërinë (8.11.2023) parashikon se *"Nën koordinimin e Kryenegociatorit dhe strukturave të riorganizuara për negociatat në BE, institucionet shqiptare kanë mobilizuar burime të konsiderueshme për t'u angazhuar në mënyrë aktive në procesin e shqyrtimit analitik, si pararendje në përgatitje për hapat e ardhshëm të negociatave të anëtarësimit"*.
- Komisioneri Várhelyi gjatë prezantimit të Raportit 2023 në Parlamentin Evropian në Bruksel, 8 nëntor 2023, u shpreh se *‘për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut procesi screening po ecën pa probleme dhe autoritetet kanë treguar një nivel të lartë përkushtimi’* dhe ka rekomanduar mbi këtë bazë dhe progresin e vendit, hapjen e negociatave për Grupkapitullin I “Themeloret” për Shqipërinë.
- Ambasadori i Bashkimit Evropian për Shqipërinë z. Soreca, në konferencën e përbashkët për shtyp më datë 8 nëntor 2023, në kuadër të dorëzimit të Raport 2023 për Shqipërinë mes të tjerash theksoi se *‘procesi i anëtarësimit të Shqipërisë është në rrugën e duhur, më shumë se një vit pas fillimit të tij: Shqipëria është angazhuar në mënyrë aktive dhe ka treguar një nivel të lartë angazhimi gjatë procesit të shqyrtimit (screening), i cili ka ecur pa probleme, dhe në përgatitjen për hapat e ardhshëm të negociatave të anëtarësimit’*.
- Komisioneri i Bashkimit Evropian për Zgjerimin dhe Fqinjësinë, Oliver Varhelyi, në dhjetor 2023 në kuadër të Samitit BE - Ballkani Perëndimor është shprehur se *‘Unioni është gati të hapë kapitujt e parë negociues me Tiranën. Kjo, pas një suksesi të plotë të fazës së parë të rishikimeve ligjore, e njohur ndryshe edhe si “screening”*.

Procesi i shqyrtimit analitik të *acquis (screening)* të negociatave me Bashkimin Evropian, i zhvilluar midis datave 15 shtator 2022 deri në 24 nëntor 2023, përfundoi në kohë dhe me sukses, më specifikisht si më poshtë vijon:

- **Shqyrtimi analitik/screening për grupimin e parë “Themeloret”, (15 shtator 2022 – 16 janar 2023)** ku përfshihen kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”, kapitulli 5 “Prokurimi publik”, kapitulli 18 “Statistikat”, kapitulli 32 “Kontrolli financiar”, kriteri ekonomik, funksionimi i institucioneve demokratike, si dhe reformat administratën publike.
- **Shqyrtimi analitik/screening për grupimin e dytë “Tregu i brendshëm”, (7 tetor 2022 – 9 mars 2023)** ku përfshihen kapitulli 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”, kapitulli 9 “Shërbimet financiare”, kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”, kapitulli 7 “E drejta e pronësisë intelektuale”, kapitulli 6 “Legjislacioni për ndërmarrjet”, kapitulli 8 “Konkurrenca”, kapitulli 2 “Lëvizja e lirë e punëtorëve” dhe kapitulli 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit”.
- **Shqyrtimi analitik/screening për grupimin e tretë “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse, (17 tetor 2022 – 8 qershor 2023)** ku përfshihen kapitulli 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”, kapitulli 19 “Politikat sociale dhe punësimi”, kapitulli 26 “Arsimi dhe kultura”, kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”, kapitulli 29 “Doganat”, kapitulli 16 “Tatimet”, kapitulli 17 “Politika monetare” dhe kapitulli 25 “Arsimi dhe shkenca”.

- **Shqyrtimi analitik/screening për grupimin e katërt “Agjenda e Gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme”, (15 mars 2023 – 29 shtator 2023)** ku përfshihen kapitulli 14 “Transporti”, kapitulli 15 “Energjia”, kapitulli 21 “Rrjetet trans-evropiane” dhe kapitulli 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”.
- **Shqyrtimi analitik/screening për grupimin e pestë “Burimet, bujqësia dhe kohezioni”, (17 korrik 2023 – 24 nëntor 2023)** ku përfshihen kapitulli 11 “Bujqësia dhe zhvillimi rural”, kapitulli 12 “Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”, kapitulli 13 “Peshkimi”, kapitulli “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore” dhe kapitulli 33 “Dispozitat Financiare dhe Buxhetore”.
- **Shqyrtimi analitik/screening për grupimin e gjashtë “Marrëdhëniet me jashtë”, (26 shtator 2023 – 17 nëntor 2023)** ku përfshihen kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë” dhe kapitulli 31 “Politika e jashtme e sigurisë dhe e mbrojtjes”.

Gjatë procesit screening për të gjashtë grupimet e kapitujve të parashtruara më sipër:

- janë zhvilluar 36 takime dypalëshe për shqyrtimin analitik për 33 kapituj dhe 3 kriteret e Bashkimit Evropian;
- mbi 1000 punonjës nga institucionet qeveritare dhe të pavarura;
- 130 institucione të përfshira në këtë proces, të cilat janë institucione qendrore, agjenci zbatuese, institucione të pavarura, institucione jobuxhetore, etj.
- janë përgatitur 777 prezantime të gjetjeve të analizës & shqyrtimit analitik të paraqitura në takimet bilaterale nga 36 ekipet shiqptare në përputhje me agjendat, të relatuara dhe argumentuara nga përfaqësues institucionesh në 36 kapitujt & nënkaptujt & kriteret për anëtarësim në Bashkimin Evropian;

Në vijim të përmbushjes në kohë dhe me vlerësim të procesit *screening*, Shqipëria, menjëherë pas finalizimit të takimeve screening në 24.11.2023, mori zyrtarisht në 30.11.2023, letrën e Presidencës Spanjolle të Këshillit të Bashkimit Evropian, për përgatitjen dhe miratimin e piketave hapëse për çeljen e negociatave për Grupkapitullin I “Themeloret”.

Në përputhje me letrën e Presidencës Spanjolle, Shqipëria e cila kishte nisur përgatitjet aktivisht muaj përpara, për përgatitjen e dy piketave hapëse, finalizoi në kohë dhe miratoi në datë 13.12.2023, me vendim të Këshillit të Ministrave, piketat hapëse të negociatave për Grupkapitullin I ‘Themeloret’:

- **Udhërrëfyesin “Shteti i së Drejtës”:** Udhërrëfyesi është një dokument politike për shtetin e së drejtës, i cili përfshin kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”. Ky udhërrëfyes parashikon masa ligjore, administrative dhe institucionale, si dhe zotime që Shqipëria merr në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Qëllimi i hartimit të tij është që nëpërmjet adresimit të hendeqeve të identifikuara gjatë procesit të shqyrtimit analitik të *acquis*, si dhe prioritizimit të masave në këtë drejtim, të sigurojë përmbushjen e standardeve për përafrimin e Aquis të Bashkimit Evropian dhe progresin në procesin e negociatave dhe integritetit evropian. Masat prioritare në këtë udhërrëfyes adresojnë çështjet që lidhen me gjyqësorin, antikorrupsionin, të drejtat themelore, garantimin e të drejtave të qytetarëve të Bashkimit Evropian, luftën kundër krimit të organizuar, bashkëpunimin në luftën kundër drogës, luftën kundër terrorizmit, bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale e civile, migracionin e rregullt dhe të parregullt, azilin, politikën e vizave, kufijtë *schengen* dhe falsifikimin e Euro-s.

- **Udhërrëfyesin “Reforma në Administratën Publike”:** Udhërrëfyesi është një dokument politike që mbështet reformën në administratën publike, me një plan masash prioritare, për periudhën kohore 2023 – 2030. Qëllimi i hartimit të tij është që nëpërmjet adresimit të sfidave të identifikuara në kuadër të procesit të shqyrtimit analitik të *acquis* – kritereve për anëtarësimin të RAP, si dhe prioritizimit të masave në këtë drejtim, të sigurojë përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e negociatave dhe integritit evropian. Masat prioritare në këtë udhërrëfyes organizohen në 5 shtylla, bazuar në parimet e Bashkimit Evropian mbi administratën publike:
  - Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
  - Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
  - Organizimi i administratës publike, llogaridhënia dhe transparenca;
  - Ofrimi i shërbimeve ndaj publikut;
  - Menaxhimi i financave publike.

Në secilën prej shtyllave të mësipërme planifikohen masa në drejtim të: (i) kuadrit strategjik/legjislativ/institucional; (ii) zbatimit të reformave dhe kapaciteteve institucionale; (iii) funksionimit dhe performancës së administratës publike.

Piketat hapëse të negociatave u dërguan zyrtarisht nga Shqipëria pranë Komisionit Evropian në datë 13.12.2023.

Shqipëria ka përmbushur kërkesat teknike (procesi *screening* dhe përgatitja dhe miratimi i piketave hapëse) për hapjen e negociatave për Grupkapitullin I “Themeloret”.

Departamenti i Politikave dhe Integritit Evropian, në Kryeministri, në rolin e Sekretariatit të Bashkimit Evropian ka bashkërenduar gjithë përgatitjet teknike në kuadër të fazës ‘*screening*’ të negociatave, si dhe ka drejtuar metodologjikisht, përgatitjet dhe mbështetur strukturat negociuese lidhur me procesin e integritit.

Për koordinimin e mirë të procesit të integritit evropian, gjatë vitit 2023 janë zhvilluar periodikisht takime të grupit negociator.

Në to janë diskutuar dhe miratuar kuadri metodologjik i Pozicionit Negociues, PSIE 2023, kuadri metodologjik i Programit Kombëtar për Anëtarësimin në Bashkimin Evropian (PKABE) dhe Planit Kombëtar të Integritit Evropian, Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës dhe Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, si piketa hapëse për Grupkapitullin 1 “Themeloret”, etj.

Për këtë periudhë raportuese rezulton se strukturat negociuese/Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integritin Evropian (GNPIE-të), nën drejtimin e Negociatorëve për secilin kapitull kanë qënë dinamike dhe kanë luajtur një rol aktiv në koordinimin e punës për arritjen e rezultateve të synuara lidhur me përgatitjet për procesin *screening*, përgatitjet për hapjen e negociatave, si dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit dhe raportimit të MSA-së.

Departamenti i Politikës dhe Integritit Evropian ka marrë masa teknike për orientimin dhe forcimin e rolit të tyre, duke drejtuar metodologjikisht planifikimin, vlerësimin dhe raportimin në kuadër të procesit të integritit evropian.

GNPIE ka koordinuar punën në kuadër të negociatave dhe ndjekjen e rekomandimeve të BE-së. Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar rreth 313 takime, në 36 GNPIE nga ku janë të angazhuar rreth 1800 anëtarë.

Për vitin 2023 rezulton se janë zhvilluar 42 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, me një pjesëmarrje në total të rreth 600 aktorëve/grupeve të interesit nga të cilët: ekspertë të fushës (40%); përfaqësuesve nga shoqëria civile (33%); dhe përfaqësuesve nga akademia/universitetet (27%).

Në zbatim të urdhrimit të Kryeministrit nr.94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” dhe në përputhje me metodologjinë e re për zgjerim të Komisionit Evropian<sup>3</sup>, një nga kriteret e anëtarësimit dhe kusht thelbësor për të gjitha vendet kandidatë për t'u bërë shtet anëtar lidhet me forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale me qëllim zbatimin në mënyrë efektive të *acquis* të BE-së si dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të integritit evropian, Sekretariati i Integritit Evropian dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) gjatë gjashtë-mujorit të dytë të vitit 2023 bashkërenduan dhe konsoliduan kuadrin metodologjik lidhur me vlerësimin e nevojave të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian për vitet 2024-2025.

Kuadri metodologjik parashikon kryerjen e procesit të vlerësimit të nevojave për rritje kapacitetesh/ trajnim (VNT) për anëtarët e të gjitha grupeve ndërinstitucionale të punës për Integrimin Evropian për periudhën 2024-2025 dhe ka si qëllim kryesor analizën e nevojave të përgjithshme të trajnimit në mbështetje të kompetencave për strukturat e integritit evropian të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian. Analiza e të dhënave të grumbulluara do të shërbejë si bazë për hartimin e një plani të përshtatshëm dhe të strukturuar për zhvillimin e kapaciteteve në periudhën 2024-2025, si masë që shoqërojnë nisjen e negociatave për anëtarësim në BE.

## 1.2 Integrimi i Përshpejtuar

Më 8 Nëntor 2023 Komisioni Evropian i paraqiti komunikatën Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian si dhe Komitetit të Rajoneve për Planin e ri për Rritje ekonomike për Ballkanin Perëndimor<sup>4</sup>.

Ky plan i ri i rritjes bazohet në metodologjinë ekzistuese të zgjerimit<sup>5</sup> dhe krijon një paketë masash përforcuese reciproke që do të shumëfishojnë përfitimet e mundshme të integritit, përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian & që shoqëron procesin e negociatave. Ai gjithashtu siguron më shumë stimuj dhe përfitime të integritit përpara anëtarësimit në BE, duke synuar kështu përshpejtimin e negociatave të anëtarësimit. Së fundi, ai shton në mënyrë progresive mundësitë financiare dhe ekonomike për Ballkanin Perëndimor përveç atyre të disponueshme sipas Marrëveshjeve ekzistuese të Stabilizim-Asociimit (MSA).

**Plani i ri i rritjes për Ballkanin Perëndimor bazohet në katër shtylla, që synojnë:**

<sup>3</sup> COM(2020) 57, datë 05.02.2020

<sup>4</sup> [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/COM\\_2023\\_691\\_Neë%20Groëth%20Plan%20Ëestern%20Balkans.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/COM_2023_691_Neë%20Groëth%20Plan%20Ëestern%20Balkans.pdf)

<sup>5</sup> COM (2020) 57 Final



1) Rritjen e integritimit ekonomik me tregun e vetëm të Bashkimit Evropian, me kusht që Ballkani Perëndimor të përafrohet me rregullat e tregut të vetëm dhe të hapë sektorët dhe zonat përkatëse për të gjithë fqinjët e tyre në të njëjtën kohë, në përputhje me Tregun e Përbashkët Rajonal;

2) Nxitjen e integritimit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Tregut të Përbashkët Rajonal<sup>6</sup>, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, të cilat potencialisht mund të shtojnë 10%<sup>7</sup> në ekonomitë e tyre;

3) Përsheptimin e reformave themelore, duke përfshirë grupimin e 'Themeloreve'<sup>8</sup>, për mbështetjen e rrugës së Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE, duke përmirësuar rritjen e qëndrueshme ekonomike përfshirë, përmes tërheqjes, investimet e huaja dhe forcimin e stabilitetit rajonal;

4) Rritjen e ndihmës financiare për të mbështetur reformat nëpërmjet një lehtësie për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor, instrument i ri me vlerë 6 miliardë euro në mbështetje të pakthyeshme dhe mbështetje kredie, me pagesë të kushtëzuar që partnerët e Ballkanit Perëndimor të përmbushin reformat themelore, dhe në veçanti reformat specifike socio-ekonomike<sup>9</sup>.

Për vendet në rrugën e anëtarësimit në BE, asociimi më i ngushtë me tregun e vetëm të BE-së do të sillte përfitime që mund të ndjeheshin drejtpërdrejt nga qytetarët e tyre. Ofrimi i më shumë mundësive për Ballkanin Perëndimor për lidhje më të ngushta me tregun e vetëm të BE-së është arsyeja kyçe e planit të rritjes.

Si pjesë e këtij plani rritjeje, **Komisioni ka identifikuar shtatë fusha prioritare fillestare, të cilat BE-ja mund t'u ofrojë vendeve të Ballkanit Perëndimor:**

#### 1. Lëvizja e lirë e mallrave:

(i) Marrëveshjet për vlerësimin e konformitetit për të zhbllokuar tregun e vetëm për mallrat e prodhuara në Ballkanin Perëndimor pas përafrimit me *acquis*, të produktit përkatës horizontal të BE-së.

(ii) Përmirësimi i marrëveshjes së bashkëpunimit doganor dhe tatimor për të përmirësuar procedurat doganore dhe për të zvogëluar kohën e pritjes në kufi, përmes masave që përfshijnë shkëmbimin paraprak të informacionit, njohjen reciproke të operatorëve ekonomikë të autorizuar, bazuar në merita, dhe bashkëpunimin më të ngushtë në zhvillimin e dritareve të tyre kombëtare të vetme dhe zbatimi më i shpejtë i *acquis* për tatimet indirekte.

(iii) Pjesëmarrja e të gjithë partnerëve të Ballkanit Perëndimor në Konventën për Tranzitin e Përbashkët: (i) kërkon marrëveshje të bazuara në dispozitat ekzistuese të MSA-ve, (ii) do të ishin marrëveshje që plotësojnë MSA-të dhe do të bazoheshin në punën ekzistuese në Tregun

<sup>6</sup> Tregu i Përbashkët Rajonal (TPR) është një nismë e dakorduar nga krerët e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në samitin e Procesit të Berlinit në Sofje në vitin 2020. TPR-ja dhe plani i veprimit i lidhur me të synojnë të sjellin katër liritë e lëvizjes (mallrat, shërbimet, kapitali dhe punëtorët) brenda rajonit.

<sup>7</sup> Gomez Ortiz Maria Del Mar; Zarate Vasquez, Roman David; Taglioni, Daria. Efektet Ekonomike të Integritimit të Tregut në Ballkanin Perëndimor (anglisht). Dokument pune për Hulumtimin e Politikave; nr. EPS 10491 Ëashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore: <http://documents.ëorlëbank.org/curated/en/09954400620232289/IDU062c50b5106fe8046d1080530898bb e45d6fa>

<sup>8</sup> Në përputhje me Komunikimin mbi "Përmirësimin e procesit të anëtarësimit – Perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor" COM(2020)57, grupi i bazave përfshin: kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, kapitulli 24 – Drejtësia, liria dhe siguria, kriteret ekonomike, funksionimi i institucioneve demokratike, reforma në administratën publike, kapitulli 5 – Prokurimi publik, kapitulli 18 – statistikat dhe kapitulli 32 – kontrolli financiar.

<sup>9</sup> Në propozimin e tij për rishikimin afatmesëm të Kornizës Financiare Shumëvjeçare 2021 – 2027 (COM(2023)337 final), Komisioni propozoi një shtesë prej 2 miliardë eurosh për Ballkanin Perëndimor. 4 miliardë euro do të jepeshin në formën e kredive koncesionare

## *Raport për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë*

e Përbashkët Rajonal ku partnerët e Ballkanit Perëndimor integrohen ndërmjet tyre në bazë të rregullave të BE-së, (iii) kërkon anëtarësimin në një konventë ekzistuese. Do të pritet nga partnerët e Ballkanit Perëndimor të mbështesin të gjitha aplikimet nga brenda rajonit.

### *2. Lëvizja e lirë e shërbimeve dhe punëtorëve:*

(i) Për e-tregtinë, shërbimet e lidhura duke përfshirë shërbimet e paketës së dërgesave<sup>10</sup>, shërbimet turistike dhe aktivitete të tjera ku është arritur marrëveshja në kuadër të Tregut të Përbashkët Rajonal. (ii) Korniza e kualifikimeve ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, duke u mbështetur në katër "marrëveshjet e lëvizshmërisë" inovatore të dakorduar në kontekstin e Tregut të Përbashkët Rajonal<sup>11</sup> përmes rritjes së bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit dhe përdorimit të mjeteve të transparencës - siç është Korniza Evropiane e Kualifikimeve (EQF) - për të lehtësuar njohjen më të shpejtë dhe më efektive të kualifikimeve.

### *3. Qasja në zonën e vetëm të pagesave në Euro (SEPA):*

Ulja e kostos së pagesave ndërkufitare në dobi të qytetarëve dhe bizneseve do të shërbejë si nxitje për tregtinë ndërkufitare. Si pjesë e punës në kuadër të Tregut të Përbashkët Rajonal, Ballkani Perëndimor po zbaton në mënyrë kolektive legjislacionin kombëtar të kërkuar nga Këshilli Evropian i Pagesave për pjesëmarrje në SEPA. Komisioni Evropian do të vazhdojë të mbështesë vendet e Ballkanit Perëndimor për të përgatitur aplikimin e tyre për qasje në SEPA.

### *4. Lehtësimi i transportit rrugor:*

(i) Mbështet vendet e Ballkanit Perëndimor për të integruar rrjetin e transportit të tyre rrugor në rajon, në bazë të miratimit të *acquis* përkatëse të BE-së. (ii) Paralelisht do të punohet drejt përfshirjes së Ballkanit Perëndimor në sistemet përkatëse të informacionit të BE-së (IMI, ERRU) Të dy veprimet ofrojnë përfitime të rëndësishme ekonomike dhe në mënyrë progresive çojnë drejt integritimit të mëtejshëm në fushën e transportit rrugor.

### *5. Integrimi dhe dekarbonizimi i tregjeve të energjisë:*

Integrimin e tregut të energjisë elektrike në rajon me atë të BE-së dhe hapja e mundësisë për integrimin e tregjeve të tjera të energjisë. Kjo do të marrë parasysh nevojën për një çmim karboni ekuivalent me çmimin e karbonit të Sistemit të Tregtimit të Emetimeve të BE-së ose aplikimin e Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit për të mundësuar bashkimin e vazhdueshëm të tregut të energjisë elektrike nga viti 2030 e më tej. Kjo do të bëhet duke zbatuar traktatin ekzistues të Komunitetit të Energjisë.

### *6. Tregu i vetëm digjital:*

(i) Lehtësimi i shtrirjes së mbulimit të marrëveshjes vullnetare aktuale për roaming mes operatorëve të telekomit<sup>12</sup>;

(ii) Ofrimi i sigurisë juridike për përdoruesit dhe operatorët për një marrëveshje afatgjatë roaming për të përfshirë Ballkanin Perëndimor në zonën e BE-së '*roam like at home*', duke respektuar plotësisht zotimet e tregtisë ndërkombëtare të Bashkimit Evropian;

<sup>10</sup> Duke u mbështetur në iniciativën ekzistuese të shërbimeve të paketës së dërgesave së brenda CEFTA-s dhe në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/644 për shërbimet e dërgesës ndërkufitare të parcelave

<sup>11</sup> Njohja e Kualifikimeve Profesionale të Doktorëve të Mjekësisë, Doktorëve të Mjekësisë Dentare dhe Arkitektëve në kontekstin e CEFTA-s; Njohja e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë; Njohja e ndërsjellë e Kualifikimeve Profesionale për Infermierët, Kirurgët Veterinarët, Farmacistët dhe Mamitë; dhe Liria e Lëvizjes me Letërnjoftim në Ballkanin Perëndimor.

<sup>12</sup> <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-12/eu-eb-roaming-declaration.pdf>

(iii) Zgjerimi i rregullave të BE-së për adresimin e Gjeo-blokut të pajustificuar dhe forma të tjera diskriminimi – bazuar në kombësinë e klientëve, vendbanimin ose vendin e krijimit – në Ballkanin Perëndimor;

(iv) Integrimi i rajonit në shërbimet e besimit të BE-së pasi legjislacioni kombëtar është në përputhje me shërbimet elektronike të identifikimit, autentifikimit dhe besimit (eIDAS). Një hap i ndërmjetëm do të jetë zhvillimi i një portofoli rajonale të identitetit digjital (“Balkan Digital Identity Wallet”) që do të përafrohet me atë të BE-së dhe do të ndjekë saktësisht të njëjtat specifikime teknike.

(v) Forcimi i lidhjeve të sigurisë kibernetike përmes mundësitë të asociimit të vendeve të BPsë në shtyllën e sigurisë kibernetike të programit të Evropës Digjitale duke parashikuar si hap të parë qasjen e tyre në Rezervën e Sigurisë Kibernetike sipas Aktit të Solidaritetit Kibernetik<sup>13</sup>. Promovimi i një zbatimi gjithëpërfshirës të Pakos së Sigurisë Kibernetike 5G të BE-së nga të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor.

(vi) Forcimi i ndërveprueshmërisë ndërkufitare përmes kornizave kombëtare të ndërveprueshmërisë që janë plotësisht në përputhje me Kornizën Evropiane të Ndërveprueshmërisë si bazë për shërbime publike digjitale të ndërveprueshme, me qytetarin në qendër.

#### *7. Integrimi në zinxhirët e furnizimit industrial:*

(i) Zhvillimi i partneriteteve strategjike për zinxhirët e vlerës së lëndëve të para të qëndrueshme, pas një fokusimi fillestar në identifikimin e projekteve konkrete të përbashkëta industriale. (ii) Zhvillimi i partneriteteve strategjike për sigurinë e furnizimit me medikamente kritike.

Zhvillimi i partneriteteve strategjike për zinxhirët e vlerës së lëndëve të para të qëndrueshme do të bazohet në: identifikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta të lëndëve të para të qëndrueshme dhe baterive që mbulojnë të gjitha fazat e zinxhirëve përkatës të vlerës, p.sh. kërkimin, nxjerrjen, përpunimin/prodhimin dhe riciklimin; dhe mbështetja e kompanive/organizatave të Ballkanit Perëndimor për t'u bashkuar me Aleancën e BE-së për Lëndët e Para dhe Aleancën e Baterive të BE-së<sup>14</sup>. Bashkëpunim më i ngushtë për kërkimin dhe inovacionin, ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet p.sh. lehtësimin e qasjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor në Akademinë e Shkathtësive të Aleancës së Baterive dhe Akademinë e Lëndëve të Para të BE-së (iii) Zgjerimi i partneriteteve strategjike ndërkombëtare të BE-së për prodhimin e ilaçeve kritike dhe përbërësve farmaceutikë aktivë.

Këto fusha prioritare do të përfshihen në agjendën e reformave në të gjithë rajonin dhe përbëjnë një lidhje të drejtpërdrejtë me punën e vazhdueshme për zbatimin e Tregut të Përbashkët Rajonal.

Lidhur me stadin aktual Plani është në proces dakordësimi dhe pritet miratimi nga Parlamenti Evropian.

<sup>13</sup> Akti i Solidaritetit Kibernetik është një propozim i Komisionit i cili ende nuk është miratuar nga bashkëligjvënësit.

<sup>14</sup> Dy Aleancat koordinohen nga dy Komunitete të Njohurisë dhe Inovacionit (KIC) të Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT).

### 1.3 Procesi i Berlinit

Me marrjen nga Shqipëria, formalisht, të kryesimit të Procesit të Berlinit për vitin 2023 gjatë Samitit 2022, vendi ka nisur menjëherë nga puna për formësimin e prioritetëve dhe hartimin e kalendarit të takimeve në kuadër të Samitit 2023.

Në kuadër të Samitit të Procesit të Berlinit, datë 16 tetor 2023, në Tiranë, u zhvilluan në pararendje ministerialet, si më poshtë vijon:

- i. Në datën 14 shtator 2023 u zhvillua **Ministeriali i Ministrave të Brendshëm të Ballkanit Perëndimor dhe të Bashkimit Evropian**, si dhe
- ii. Në datën 26 shtator 2023 u zhvillua **Forumi i Ministrave të Ekonomisë me titull, “Tregu i përbashkët rajonal – një hap drejt Tregut Unik të BE-së”**.
- iii. Në datën 6 tetor 2023 u zhvillua takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme të Procesit të Berlinit.

**Ministeriali dhe Forumi i ministrave të Brendshëm të Ballkanit Perëndimor<sup>15</sup> dhe të Bashkimit Evropian** diskutuan mënyrat konkrete për të rritur bashkëpunimin, mbështetjen për të vënë në zbatim programin e çështjeve të brendshme të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit. Ministrat e Brendshëm theksuan vlerën strategjike të fuqizimit të besimit, përmirësimit të bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, rritjen e bashkëpunimit brenda sferës së menaxhimit të integruar të kufirit dhe përdorimit të mënyrave të tjera për të trajtuar çështje të sigurisë kibernetike në një përpjekje të bashkërenduar rajonale.

- Ministrat ranë dakord për t’u fokusuar më shumë në menaxhimin integruar të kufijve, përfshirë këtu zhvillimin e strategjive dhe bashkërendimin e mëtejshëm të nismave ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke kërkuar njëkohësisht mbështetje më të fortë nga BE-ja për rritjen e kapaciteteve, digjitalizimin dhe forcimin e sigurisë së kufirit dhe migracionit.
- Ministrat ranë dakord për të trajtuar çështjet migratore, si një nga çështjet me përparësi për rajonin dhe paraqitjen domosdoshmërinë për mbështetje të mëtejshme nga partnerët evropianë për ndërtimin e sistemeve të shkëmbimit të informacionit, veprimeve të përbashkëta dhe analizës së riskut, për të rritur efikasitetin në monitorimin ekufijve, si dhe për trajnime të mëtejshme dhe pajisje.
- Përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor theksuan vendosmërinë e tyre në luftën kundër krimit të organizuar.
- Në këtë kuadër, ngritja e Task-Forcave të përbashkëta dhe bashkëpunimi për aspekte të ndryshme specifike në luftën kundër krimit të organizuar si trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda por edhe trafikimi i lëndëve narkotike, u përcaktua si mënyra e duhur për të ecur përpara.
- Përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor theksuan rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke pasur parasysh natyrën ndërkombëtare të kërcënimeve kibernetike. U theksua roli i qendrave rajonale dhe kombëtare të kibernetikës, si mënyra më e mirë e mundur për të bashkërenduar bashkëpunimin në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe BE-në. Vendet e Ballkanit Perëndimor kërkuan që të jenë të

---

<sup>15</sup><https://mb.gov.al/ministeriali-i-ministrave-te-brendshem-te-be-dhe-ballkanit-perendimor-ne-kuader-te-procesit-te-berlinit-ne-tirane/>

përfshira në Rrjetin e Ekipit të Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike (CSIRT), në kuadër të zbatimit të Direktivës NIS2.

**Forumi i ministrave të Ekonomisë “Tregu i përbashkët rajonal – një hap drejt Tregut Unik të BE-së”<sup>16</sup>**, mbledhi së bashku ministrat e Ekonomisë të vendeve pjesë e Procesit të Berlinit, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, si dhe partnerë të tjerë. Forumi u fokusua në avancimin e tregut të përbashkët rajonal, nxitjen e zhvillimit dhe rritjes ekonomike, si dhe në afrimin me Bashkimit Evropian. Forumi i ministrave shqyrtoi arritjet, prioritetet dhe sfidat kryesore në avancimin e agjendës së integritit rajonal përmes lehtësimit të tregtisë dhe reduktimit të barrierave teknike, integritit të tregjeve, integritit të sistemeve të pagesave dhe përgatitjes ekonomike të Ballkanit Perëndimor për një integrim gradual në Eurozonë, më specifikisht:

- Ministrat theksuan se përafrimi i hershëm me Tregun Unik të BE-së është arritur përmes marrëveshjeve tregtare ndërmjet BE-së dhe kandidatëve të saj, përmes Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit dhe përmes CEFTA-s, ndërmjet vetë kandidatëve. Këto marrëveshje janë të rëndësishme për të arritur nivelin e parë të përafrimit ekonomik dhe një zonë të tregtisë së lirë, si hap i parë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.
- Ministrat shprehën mbështetje të fortë për përafrimin e mëtejshëm ekonomik të Ballkanit Perëndimor me Tregun Unik të BE-së, përmes procesit të zgjerimit të BE-së, si një përfitim i ndërsjelltë për rajonin dhe për BE-në.
- Ministrat kërkuan shtrirjen e mëtejshme dhe përsheptimin e integritit në programet dhe politikat individuale të BE-së, siç përcaktohet në metodologjinë e negociatave të pranimit në BE. Zbatimi i mëtejshëm i Planit Ekonomik dhe të Investimeve të Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor, i cili synon integrimin më të ngushtë të rajonit me BE-në, duke u fokusuar në tregtinë e mallrave, tregtinë elektronike dhe integrimin në zinxhirët e vlerës së qëndrueshme, vlerësohet si një hap i vlefshëm në të ardhmen.
- Ministrat kërkuan zgjerim të bashkëpunimit me BE-në për të krijuar themele mbi shembujt aktualë të rëndësishëm si iniciativa CEFTA – Komuniteti i Transportit (TCT) Korsitë e Gjelbërta brenda Ballkanit Perëndimor, zgjerimin e tyre në pikat e kalimit kufitar (PKK) me BE-në dhe iniciativa e drejtuar nga RCC-ja për uljen e kostove *roaming* ndërmjet WB6 dhe BE-së.
- Ministrat mirëpritën punën në udhërrëfyesin për çuarjen përpara të Korsive të Gjelbërta, BE-CEFTA/Ballkani Perëndimor, për vendosjen e menaxhimit të koordinuar të kufirit në pikat e kalimit kufitar BE – Ballkani Perëndimor, si dhe propozimin për një fazë të dytë të Programit të Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit (TTFP 2). Faza e dytë duhet të mbështesë zbatimin e hartës së masave lidhur me tregtinë dhe përmirësimin e infrastrukturës së kalimeve kufitare.
- Duke marrë parasysh arritjet në kuadër të programit Rajonal të Zhvillimit të Furnizuesve të zbatuar nga Forumi i Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor 6 (WB6 CIF) dhe duke përshëndetur rolin e luajtur nga sektori privat në zbatimin e TPR, ministrat shprehën mbështetje për vazhdimin e këtij programi të udhëhequr nga WB6 CIF. Ministrat mbështetën ndërlidhjen e mëtejshme të këtij programi me mekanizmat mbështetës kombëtarë në rajon, për të siguruar pjesëmarrjen e NVM në zinxhirët e furnizimit shumëkombësh dhe krijimin e partneriteteve të reja rajonale midis kompanive të BP6.

---

<sup>16</sup> <https://financa.gov.al/konkluzionet-e-forumit-te-ministrave-te-ekonomise-ne-kuader-te-procesit-te-berlinit/>

- Ministrat përshëndetën vazhdimin e bashkëpunimit përmes Fondit Rajonal të Sfidës (RCF) në Ballkanin Perëndimor të iniciuar nga BMZ dhe KfW dhe të zbatuar nga Forumi i Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor 6 (WB6 CIF) për të mbështetur punësimin e të rinjve dhe rritjen ekonomike. Ata mbështesin vazhdimin e këtij programi përmes formimit profesional dhe krijimit të vendeve të punës për t'u ofruar të rinjve perspektiva më të mira në vendin e tyre.
- Ministrat propozuan gjithashtu disa iniciativa që të futen në planin e rritjes për Ballkanin Perëndimor, si p.sh.:
  - o Programi për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit 2.0.
  - o Integrimi i Ballkanit Perëndimor në Aleancën Evropiane të Lëndëve të Para.
  - o Integrimi i Sistemeve të Pagesave të Bankave Qendrore të rajonit me atë Evropian.
  - o Vendosja e shërbimeve të zhvillimit të biznesit dhe shërbimeve këshilluese, të cilat do të përgatisin dhe forcojnë sipërmarrësit rajonalë për të konkurruar dhe progresuar në Tregun Unik.
- Ministrat bënë **thirrje për përsheptimin e zbatimit të Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal**. Zbatimi i Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal do të nxisë rritjen ekonomike të rajonit dhe do ta sjellë atë më afër BE-së, duke lehtësuar lëvizjen e mallrave dhe shërbimeve përmes programeve të njohjes, duke zvogëluar kohën e pritjes në pikat e kalimit të kufirit, duke rritur lëvizshmërinë dhe duke ofruar pagesa më të lira dhe më efikase.
- Ministrat reflektuan për sfidat kryesore në zbatimin e agjendës rajonale të integritimit, e cila do të përshpejtojë konvergjencën ekonomike të rajonit me Bashkimin Evropian. Ata parashtruan një listë angazhimesh deri në Samitin e ardhshëm të Procesit të Berlinit, si integrimi i sistemeve të pagesave të rajonit për të lehtësuar tregtinë dhe për të përgatitur Ballkanin Perëndimor për një integrim eventual në Eurozonë.

**Takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme të Procesit të Berlinit u zhvillua** më 6 tetor 2023 në Tiranë. Ministrat diskutuan për situatën gjeopolitike në rajonin më të gjerë dhe në Ballkanin Perëndimor, si dhe u konstatuan arritjet në kuadër të Procesit të Berlinit dhe sfidat e bashkëpunimit rajonal, me synimin për të shprehur vullnetin politik për forcimin e këtij bashkëpunimi. Ata vlerësuan se:

- Procesi i Berlinit mbetet platforma më e rëndësishme e bashkëpunimit rajonal dhe një hallkë ndërlidhëse dhe stimuluese e agjendës së anëtarësimit në BE, pa e zëvendësuar atë.
- Tregu i Përbashkët Rajonal konsiderohet një hap i rëndësishëm drejt Tregut Unik të BE-së. Për këtë arsye, ndërveprimi ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të avancojë, duke krijuar lehtësira të vazhdueshme për krijimin e tregut ekonomik rajonal, si një portë për në tregun e përbashkët të BE-së.
- Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të kenë disa mundësi për integrim të hershëm (të përshpejtuar) në tregun e përbashkët evropian.
- Ballkani Perëndimor duhet të përfshihet në zinxhirin e vlerave të BE-së.
- Vendet tona duhet të mbështeten financiarisht, përpara anëtarësimit në BE, qoftë nëpërmjet ristrukturimit të fondeve të para-anëtarësimit apo aksesit të hershëm në fondet strukturore të BE-së para anëtarësimit, natyrisht duke respektuar parimin e kushtëzimit.

### **Samiti i Procesit të Berlinit në Tiranë**

Më 16 tetor 2023, u organizua në Tiranë Samiti i Procesit të Berlinit, nën kryesinë shqiptare të Procesit të Berlinit. Në Samit morën pjesë krerët e qeverive të Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Kosovës dhe Bosnjë dhe Hercegovinës, si dhe krerët e shteteve ose qeverive ose përfaqësues, të Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Italisë, Polonisë, Sllovenisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, Spanjës, Hungarisë, Rumanisë dhe Holandës, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian (BE) dhe të organizatave dhe institucioneve financiare rajonale dhe ndërkombëtare, etj.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor në kontekstin aktual gjeopolitik. Ata theksuan rëndësinë e forcimit të lidhjeve, transportit, tregtisë, energjisë dhe digjitalizimit në Ballkanin Perëndimor, si dhe midis rajonit dhe BE-së.

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6) përshëndetën shpalljen e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor nga Presidentja e Komisionit Evropian, në maj 2023, dhe shprehën angazhimin e tyre për avancimin e integritit ekonomik rajonal përmes Tregut të Përbashkët Rajonal, nëpërmjet përshejtimit të reformave të brendshme, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Pjesëmarrësit e WB6 shprehën nevojën për të kapërcyer hendekun socio-ekonomik dhe për të rritur konvergencën midis Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim, ata shprehën interesin e tyre për të rritur bashkëpunimin mes tyre dhe, aty ku është e mundur, me BE-në në një sërë fushash të politikave, si Zona e Vetme e Pagesave në Euro (SEPA), lehtësimi i tregtisë dhe transportit, telekomunikacionit dhe digjitalizimit, klimës, energjia, bujqësia, siguria, rinia, arsimit dhe shkenca, etj. Pjesëmarrësit e BP6 mbështetën një monitorim periodik të strukturuar të konvergencës ekonomike të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së.

Disa nga arritjet e këtij Samiti ishin:

- Nënshkrimi i “Marrëveshjes Rajonale për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale të Infermierëve, Kirurgëve Veterinarë, Farmacistëve dhe Mamive në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore”
- Miratimi i Deklaratës së Përbashkët Rajonale për parandalimin e ndotjes plastike, përfshirë mbetjet detare
- Miratimi i Deklaratës së Përbashkët për Zonën e Pagesave për Evropën.(SEPA)
- Miratimi i Deklaratës së Përbashkët për Nismën Wi-Fi për Ballkanin Perëndimor
- Miratimi i Deklaratës së Përbashkët për Krijimin e Observatorit të Konvergencës në Ballkanin Perëndimor
- Miratimi i Deklaratës së Përbashkët të Ballkanit Perëndimor, Bankës Botërore, Palëve të Evropës Juglindore të Traktatit të Komunitetit të Transportit dhe CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit
- Miratimi i Deklaratës së Përbashkët të Qëllimit ndërmjet Liderëve të Ballkanit Perëndimor dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Partneritetin Rajonal të Klimës.

Pjesëmarrësit përshëndetën hyrjen në fuqi të tre marrëveshjeve të lëvizshmërisë, të nënshkruara në Berlin, në nëntor 2022, për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë dhe kërkuan ratifikimin/miratimin e këtyre marrëveshjeve nga të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor.



Në margjinat e Samitit të Procesit të Berlinit u lançua hapja e thirrjes për vitin e parë të Masterit të Kolegjit të Evropës, Kampusi i Tiranës me programin pasuniversitar për Transformimin dhe Integrimin Evropian për vitin shkollor 2024-2025.

Liderët përshëndetën edhe hyrjen në fuqi me 1 tetor 2023, të tarifave të reduktuara të *roaming* ndërmjet BE dhe Ballkanit Perëndimor, të nënshkruar gjatë samitit BE-BP në Tiranë, me 6 dhjetor 2022.

#### 1.4 Integrimi Evropian në nivel vendor

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një proces kompleks dhe gjithëpërfshirës, i cili bëhet realitet nëpërmjet kontributit të të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjithë shoqërisë. Integrimi në Bashkimin Evropian përbën një objektivi për pushtetin vendor.

Për të adresuar sa më sipër, një sërë masash janë ndërmarrë gjatë vitit 2023 për të mbështetur bashkitë dhe administratën e tyre në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative lidhur me procesin e integritimit evropian.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ka zhvilluar Dialogun Vendor në 61 bashkitë e vendit. Gjatë këtyre takimeve, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV kanë theksuar rëndësinë dhe rolin e bashkive dhe NjIE-ve në procesin e Integritimit Evropian në nivel vendor.

Në kuadër të qeverisjes vendore, ngritja e një këndi të BE-së/EU Desk në çdo bashki kushtuar Bashkimit Evropian është një nismë e përbashkët me BE. Këndet e BE-së janë ngritur tashmë dhe janë funksionale. Ato kontribuojnë në shpërndarjen e informacionit dhe angazhimin e administratës vendore dhe qytetarëve në çështjet që kanë lidhje me BE-në: politikat e saj, fondet dhe programet.

Gjatë vitit 2023, me qëllim vlerësimin e përfshirjes së bashkive në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian është realizuar rishikimi i plotë i rregulloreve të brendshme për 61 bashkitësi dhe 61 këshillat bashkiakë, nga ku rezultuan se:

- Nga 61 bashki, vetëm 18 prej tyre kanë përfshirë funksionet që lidhen me koordinimin e proceseve integruese në BE dhe strukturat përkatëse, në rregulloren e tyre të brendshme (koordinim të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i përgjithshëm i integritimit në BE, aksesit në fondet e BE-së, organizimi i informacionit publik dhe ngjarjeve ndërgjegjësuese mbi proceset e lidhura me BE-në).
- Nga rishikimi i rregullores së 61 këshillave bashkiakë, rezultoi se 50% e këshillave të bashkive kishin në strukturën e tyre një komision për çështjet e Integritimit Evropian.
- 60% e njësive kanë më shumë se 1 të punësuar. Vetëm bashkitë: Poliçan dhe Skrapar, nuk kanë të punësuar në njësitet e Integritimit Evropian (NjIE). Tirana dhe Përmeti raportojnë numrin më të madh të të punësuarve në NjIE, përkatësisht 8 në Tiranë dhe 7 në Përmet.
- 38% e bashkive (23 bashki) punësojnë vetëm një specialist që merret me çështjet e integritimit në BE. Në përgjithësi, përveçse në Bashkinë e Korçës, NjIE me 1 person ekziston zakonisht në bashkitë e vogla.



Gjatë këtij viti ka përfunduar ngritja dhe plotësimi i bazës së të dhënave online për projektet e financuara nga donatorët dhe që zbatohen nga bashkitë. Baza e të dhënave përmban informacion mbi 224 projekte në zbatim. Baza e të dhënave do të ofrojë informacion për të gjitha projektet e menaxhuara nga bashkitë, të financuara përmes programeve/mekanizmave të ndryshëm të financimit të donatorëve duke filluar nga viti 2021, duke shërbyer si një mjet efektiv për të evidentuar gjeografinë e shpërndarjes së projekteve, si dhe një mjet i vlefshëm për të vlerësuar se si çdo program financimi po kontribuon në zhvillimin ekonomik e social të komuniteteve lokale.

BE-ja është donatori më i madh në Shqipëri në nivelin e pushtetit vendor, duke përbërë 54% të totalit të financimit të donatorëve.

### Ofrimi i trajnimeve

Gjatë vitit 2023, me qëllim ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve janë zhvilluar trajnime për (i) rritjen e kapaciteteve të bashkive në thirrjet e reja për propozime të nisura në kuadër të Programeve të Unionit me fokus në nivelin lokal (Binjakëzimi dhe Angazhimi Civil nën CERV - Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat) dhe Horizon Europe, (ii) trajnime të synuara për stafin e menaxhimit të nivelit të lartë të bashkive (Sekretarët e Përgjithshëm/ Nënkryetarët/ Drejtorët e Drejtorive/ Drejtorët/ Këshilltarë e stafe të NjIE etj. (iii) organizimi i një seri trajnimesh me ekspertë të BE-së për procedurat e PRAG dhe (iv) Trajnime për ekipet e reja të Njësive të BE-së mbi rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

- Rëndësi i është kushtuar përgatitjes së bashkive për të kuptuar e zbatuar me sukses në të ardhmen Politikën dhe Fondet e Kohezionit të BE-së. Për këtë qëllim u zhvilluan në datat 22 dhe 27 qershor 2023 trajnimet mbi këtë temë me 53 bashki pjesëmarrëse.
- Gjatë periudhës raportuese, është koordinuar puna me strukturat e *TAIEX* në Bruksel për të organizuar vizita studimore me përfaqësues të MB, AMVV dhe Njësive të Integritimit Evropian.

Rreth 12 bashki aplikuan në programin *Europe Goes Local*, nga ku 3 kanë dalë të suksesshëm që në fazën e parë.

Në këtë kuadër, janë organizuar takime orientuese dhe mentoruese *online* me 14 bashki nga 26 që kishin shprehur interesim për të aplikuar në thirrjen për propozime në programet BE. Janë dërguar 9 aplikime nga 6 bashki: Kavaja, Finiqi, Libohova, Lushnja (2 aplikime, 1 *lead*) Vlora (2 aplikime), Kukësi, dhe Roskoveci.

- Trajnimi “Si të përgatitet një projektpropozim i suksesshëm” për thirrjet e reja në kuadër të Programit të Unionit *Horizon Europe 2021-2027*. *Horizon Europe 2021-2027* është pasardhësi i *Horizon 2020* (cikli 2014-2020), programi më i madh i BE-së në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit. MFE-ja ka organizuar sesione informative të pasuara me trajnime gjatë 2023. Aktualisht po shtohen thirrjet, ku mund të aplikojnë bashkitë në fushën e trashëgimisë kulturore, turizmit, mjedisit, shëndetësisë etj;
- MFE në koordinim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) dhe ASPA-n ka organizuar trajnime të dedikuara dhe më pas, mentorim, për bashkitë në thirrjet e reja të Programit *Horizon Europe*, lehtësimin e kërkimit dhe rrjetëzimit të partnerëve, si dhe u ofron atyre informacionin e nevojshëm për

shpërndarjen e informacionit për grupe të tjera të interesuara brenda komuniteteve të tyre.

- Gjatë 2023, AMVV-ja, me mbështetjen e projektit të BE-së, përgatiti masat para përgatitore për organizimin e misionit të ekspertëve të TAIEK dhe seminarit me bashkitë për standardet e shërbimit social, që u zhvilluan gjatë 2023.

### **Forumi i Qeverisjes Vendore “Bashkitë dhe Procesi i Integritimit në BE: Shkëmbimi i praktikave më të mira në Evropën Juglindore”**

Më 13 tetor 2023, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV, në bashkëpunim me dy projektet e financuara nga Bashkimi Evropian : “BE për Bashkitë” dhe “Bashkitë për në Evropë”, Shoqatën për Autonominë Lokale dhe Rrjetin e Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), organizuan Forumin e Qeverisjes Vendore: "Bashkitë dhe Procesi i Integritimit në BE: Shkëmbimi i praktikave më të mira në Evropën Juglindore". Forumi u mbajt vetëm pak ditë përpara Samitit të Procesit të Berlinit, me qëllim krijimin e një platforme për dialog dhe shkëmbime eksperiencash ndërmjet kryetarëve të bashkive dhe zyrtarëve të autoriteteve vendore nga Shqipëria dhe vendet e Europës Juglindore për të ndarë praktikat më të mira mbi rolin e bashkive në procesin e integritimit në BE dhe instrumenteve për të lehtësuar thithjen e ndihmës financiare të BE për autoritetet vendore.

### **Organizimi i aktiviteteve publike**

Gjatë vitit 2023, Njësitë e IE kanë organizuar aktivitete publike në kuadër të ditëve të shënuara të Bashkimit Evropian si dhe ditëve të tjera ndërkombëtare që shënohen edhe nga vendet anëtare të BE-së. 16 aktivitete publike janë organizuar nga NjIE në kuadër të Ditëve Evropiane të Solidaritetit Lokal, Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, Ditës Evropiane të Qyteteve dhe Rajoneve, Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve, Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve si dhe Ditës Evropiane të Gjuhëve.

### **Informimi dhe komunikimi**

Gjatë 2023, AMVV-ja, në bashkërendim me projektin “BE-ja për bashkitë”, ka ofruar mbështetje për NjIE për organizimin e shkollave verore për BE-në, Javën Evropiane të Lëvizshmërisë<sup>17</sup>, Javën Evropiane të Sporteve<sup>18</sup>dhe Ditën Evropiane të Gjuhëve<sup>19</sup>.

---

<sup>17</sup><https://mobilityeek.eu/home/>

<sup>18</sup><https://sport.ec.europa.eu/european-eek-of-sport>

<sup>19</sup><https://eek.coe.int/en/eek/portal/26-september-european-day-of-languages>

## **PJESA II: PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN (2023-2025)**

Përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij, janë një nga kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Procesi i negociatave të anëtarësimit është në vetvete procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përafruar legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian<sup>20</sup>:

- Pika 1 përcakton se “Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe të imponohet si duhet.

Në përputhje me nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit hartohet dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave Plani Kombëtar për Integrimin Evropian.

Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (në vijim PKIE) ka si synim të adresojë përmes masave strategjike dhe ligjore, institucionale dhe zbatuese linjëzimin e kuadrit rregullator vendas me *acquis* të BE-së si dhe zbatimin efektiv të tij.

---

<sup>20</sup> <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2006/07/27/9590/92c1cfc1-2743-4c3f-9750-e36fdd90a9cc>

PKIE është e lidhur me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe në të njëjtën linjë më PBA-në, mbulon një periudhë 3 vjeçare buxhetimi dhe përditësohet çdo vit.

Cikli i hartimi dhe monitorimit të PKIE përbëhet nga këto procese:

1. Puna përgatitore;
2. Analiza e mangësive;
3. Planifikimi;
4. Hartimi dhe kontrolli i cilësisë;
5. Konsultimi dhe miratimi;
6. Monitorimi, raportimi, dhe vlerësimi.

Fazat e analizës së mangësive ligjore dhe institucionale dhe planifikimi i tyre janë veçanërisht të rëndësishme në këtë cikël planifikimi dhe monitorimi..

Në analizën e mangësive ligjore dhe përcaktimin e masave prioritare në PKIE 2023 – 2025, institucionet përgjegjëse kanë pasur një vëmendje të veçantë:

- analizën e mangësive ligjore (LGA) dhe institucionale (IAGA) për çdo kapitull të *acquis*;
- rekomandimet e Komisionit në Raportin e vitit 2022 për Shqipërinë;
- rekomandimet e dhëna në kuadër të takimeve dhe mekanizmave të përbashkëta të ngritura në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- përputhshmërinë me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030<sup>21</sup> dhe Programin e Qeverisë shqiptare<sup>22</sup> si dhe dokumentet e tjera strategjike të miratuara.

Në bazë të urdhrat të Kryeministrit nr. 94, datë 20.05.2019, grupet ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, të drejtuara nga negociatorët përkatës, janë përgjegjëse për bashkërendimin e hartimit dhe përafrimin në Acquis të kapitullit përkatës të PKIE-së. Për këtë arsye, hartimi i projektakteve dhe monitorimi i procesit të finalizimit të tyre me procedura miratuese bëhet në konsultim të vazhdueshëm me ministrinë/ institucionin koordinues lider dhe anëtarët e tjerë të grupit ndërinstitucional të punës.

### **Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025**

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2023 – 2025 u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.122, datë 1.3.2023, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025”.

PKIE 2023 – 2025 përfshin masat ligjore dhe zbatuese që janë parashikuar të zbatohen gjatë periudhës 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2025. PKIE rishikohet çdo vit, duke pasqyruar prioritetet dhe rekomandimet e reja që jepen nga Komisioni Evropian gjatë periudhës para planifikimit, si dhe planifikimin e prapambetur.

Për të gjithë periudhën e planifikimit janar 2023 – dhjetor 2025 të përfshirë në PKIE janë planifikuar në total 204 masa ligjore dhe dokumente strategjik si më poshtë:

- Për periudhën janar – dhjetor 2023 në total 91 masa ligjore/dokumente strategjik,

<sup>21</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88>

<sup>22</sup> [https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi\\_Qeverises\\_2021-2025.pdf](https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf)

- Për periudhën janar – dhjetor 2024 në total 72 masa ligjore/dokumente strategjik,
- Për periudhën janar – dhjetor 2025 në total 35 masa ligjore/dokumente strategjik.

### Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, 2023 - Ecuria

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025 parashikonte në tërësi, për vitin 2023, miratimin e 91 akteve ligjore që synonin përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe miratimin e dokumenteve strategjike që kanë lidhje me procesin e anëtarësimit dhe zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në total, gjatë vitit 2023 u miratuan 61 akte ligjore dhe nënligjore të parashikuara në PKIE. Numri i akteve të miratuara lehtësisht ishte më e lartë se ai e vitit 2022 ku u miratuan në total 59 akte ligjore dhe nënligjore.

Aktet e miratuara kanë përafruar më tej legjislacionin kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fusha të tilla me rëndësi si: lëvizja e lirë e mallrave dhe akreditimi, shërbimet financiare, rrjetet dhe shërbimet digjitale, siguria ushqimore, menaxhimi i hapësirës detare dhe i burimeve ujore, transporti hekurudhor dhe ai ajror, statistikat, doganat, konkurrenca, etj.

Ministritë e linjës, Kryeministria miratuan 50 akte gjatë vitit 2023. Ndërkohë institucionet e pavarura dhe ato të krijuara me ligj miratuan 11 akte gjatë vitit 2023.

Tabela 1: Shkalla e realizimit sipas ministrive

Ministria propozuese	Nr. i akteve të MIRATUAR	Akte të hartuara 2023, në fazë të AVANCUAR, për miratim 2024-2025
Ministria e Mbrojtjes	2	0
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	10	2
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	16	3
Ministria e Arsimit dhe Sportit	4	1
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	8	4
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	1
Ministria e Brendshme	1	3
Ministria e Drejtësisë	1	2
Kryeministria	7	7
Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar	1	0
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	5	1
Agjencia e Prokurimit Publik	1	1
Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike	0	2
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	0	3
<b>Total</b>	<b>50</b>	<b>23</b>

Tabela 2: Shkalla e realizimit sipas institucioneve të pavarura

Institucioni propozues	Nr. i akteve të MIRATUAR
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	4
Autoriteti i Konkurrencës	3
Banka e Shqipërisë	1
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	1
INSTAT	2
<b>Total</b>	<b>11</b>

Gjatë 2023 INSTAT ka hartuar edhe 1 akt ligjor (stad i avancuar përgatitje) i cili përaftron EU acquis, por që miratimi i tij do të bëhet gjatë 2024.

**Nga 61 aktet të miratuara për vitin 2023, 10 prej tyre ishin në përgjigje të drejtpërdrejtë të rekomandimeve të bëra nga shërbimet e Komisionit Evropian, ndërsa të tjerat në përgjigje të nevojës për përafrim të Aquis sipas kapitujve/fushave..**

**Aktet që adresuan realizimin e rekomandimeve janë si më poshtë:**

1. Ligj nr. 92/2023, datë 2.11.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”;
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 7.4.2023, “Për miratimin e dokumentit politik “Për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri, 2023 – 2027”, përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare, Kapitulli 9 “Shërbimet financiare”;
1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 366, datë 16.6.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023 – 2027”, përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 “Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve”;
3. Udhëzim i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, datë 11.12.2023, “Për miratimin e udhëzimit “Për zbatimin e parimeve për matjen e çmimeve dhe vëllimeve në llogaritë kombëtare”, përgatitur nga Instituti i Statistikave, Kapitulli 18 “Statistikat”;
4. Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 705, datë 18.12.2023, “Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë 2024 – 2027”, përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”,;
5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 24.03.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023 – 2024”, përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kapitulli 19 “Politikat sociale dhe të punësimit”;

6. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 8.11.2023, “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Erzen 2024 – 2029”, përgatitur nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Kapitulli 27 “Mjedisi”;
7. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 624, datë 8.11.2023, “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024 – 2029”, përgatitur nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Kapitulli 27 “Mjedisi”;
8. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Mat 2024–2029”, përgatitur nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Kapitulli 27 “Mjedisi”;
9. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 28.12.2023, “Për miratimin e listave të mallrave, që mund të përdoren ose nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”, përgatitur nga Ministria e Mbrojtjes, Kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë”.

Sipas tipologjisë së akteve të planifikuara, ecuria e PKIE 2023 paraqitet si më poshtë:

- **Për vitin 2023 u miratuan 8 ligje.**
- **U miratuan 20**
- **Udhëzime, etj., janë miratuar 33.**

**Ligjet e miratuara gjatë 2023, janë si më poshtë:**

1. Ligj nr. 92/2023, datë 2.11.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”,
2. Ligj datë 13.12.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përgatitur nga Agjencia e Prokurimit Publik, Kapitulli 5 “Prokurimi publik”,
3. Ligj nr. 100/2023, datë 14.12.2023, “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë, Kapitulli 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”,
4. Ligj nr. 87/2023, datë 2.11.2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Bashkimit Evropian, nga ana tjetër, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit “Evropa Digjitale” (2021 – 2027)”, përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 10 “Transformimi digjital”,
5. Ligji nr. 30/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, Kapitulli 10 “Transformimi digjital”,
6. Ligj nr. 50/2023, datë 22.06.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedisi”, të ndryshuar, përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Kapitulli 27 “Mjedisi”,
7. Ligj datë 20.12.2023 “Për strategjinë detare në Republikën e Shqipërisë”, përgatitur nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Kapitulli 27 “Mjedisi”,
8. Ligj datë 28.12.2023 “Për burimet ujore”, përgatitur nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Kapitulli 27 “Mjedisi”.

**Projektvendimet e miratuara të Këshillit të Ministrave gjatë 2023, janësi më poshtë:**

1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 7.4.2023, "Për miratimin e dokumentit politik "Për krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri, 2023-2027", përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Kapitulli 9 "Shërbimet financiare",
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 24.03.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024", përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kapitulli 19 "Politikat sociale dhe të punësimit",
3. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 189, datë 5.4.2023, "Për miratimin e platformës së monitorimit dhe verifikimit", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 15 "Energjia",
4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 4.5.2023 "Për përcaktimin e kategorive të tjera të ndërtesave që përjashtohen nga ligji nr. 116/2016, "Për performancën e energjisë në ndërtesa", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 15 "Energjia",
5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 14.2.2023, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023-2025", përgatitur nga Ministria e Brendshme, Kapitulli 24 "Drejtësia, liria dhe siguria",
6. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 366, datë 16.6.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023-2027", përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 "Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve",
7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 19.7.2023, "Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2021 për llogaritjen e pensioneve", përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kapitulli 19 "Politikat sociale dhe të punësimit",
8. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 28.9.2023, "Për indeksimin e pensioneve", përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kapitulli 19 "Politikat sociale dhe të punësimit",
9. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 13.12.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 378, datë 5.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 1 "Lëvizja e lirë e mallrave",
10. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 22.11.2023, "Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe të identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil", përgatitur nga Ministria e Mbrojtjes, Kapitulli 1 "Lëvizja e lirë e mallrave",
11. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 28.12.2023 "Për miratimin e listave të mallrave, që mund të përdoren ose nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare", përgatitur nga Ministria e Mbrojtjes, Kapitulli 30 "Marrëdhëniet me jashtë",



12. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.816, datë 28.12.2023, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2024”, përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kapitulli 29 “Doganat”,
13. Vendim i Këshillit të Ministrave datë 28.12.2023, “Për miratimin e kërkesave për dhënien e licencës së operimit për kryerjen e shërbimeve ajrore, procedurat, kriteret dhe kushtet për refuzimin, pezullimin apo revokimin e licencës së operimit, si dhe rregullat bazë për të garantuar operimin e sigurt të një operatori”, përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 “Transporti”,
14. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 20.9.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Kapitulli 25 “Shkenca dhe kërkimi”,
15. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 28.12.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Kapitulli 26 “Arsimi dhe kultura”,
16. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 28.12.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”, përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 13 “Peshkimi”,
17. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 8.11.2023, “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Erzen 2024-2029”, përgatitur nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Kapitulli 27 “Mjedisi”,
18. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 624, datë 8.11.2023, “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024-2029”, përgatitur nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Kapitulli 27 “Mjedisi”,
19. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Mat 2024-2029”, përgatitur nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Kapitulli 27 “Mjedisi”,
20. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 792, datë 28.12.2023 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për sigurinë e informacionit të klasifikuar, që trajtohet në Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit (SKI)”, përgatitur nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Kapitulli 31 “Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes”.

**Akte të tjera nënligjore të miratuara gjatë 2023, janë si më poshtë:**

1. Udhëzim i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë, 29.03.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.16, datë 26.4.2019 “Për llojet, procedurat dhe mënyrat për lëshimin e certifikatave, si dhe formatet që do të përdoren në sistemin e arsimit dhe formimit profesional”, përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kapitulli 26 “Arsimi dhe kultura”,
2. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 42, datë 27.03.2023, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 “Transporti”,

3. Vendimi i Bordit Drejtues nr. 16, datë 28.02.2023, “Për miratimin e Rregullores “Për ushtrimin e veprimtarisë operacionale të shoqërive komisionere dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi”, përgatitur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Kapitulli 9 “Shërbimet financiare”,
4. Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 990, datë 8.06.2023, “Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për raste individuale”, përgatitur nga Autoriteti i Konkurrencës, Kapitulli 8 “Konkurrenca”,
5. Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 7, datë 6.09.2023, “Për miratimin e dokumentit “Plani i përdorimit të frekuencave”, përgatitur nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Kapitulli 10 “Transformimi digjital”,
6. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 80, datë 30.6.2023, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”, përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 “Transporti”,
7. Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 202, datë 25.04.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e programit mësimor të gjuhës angleze për klasat I-V në sistemin arsimor parauniversitar”, përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Kapitulli 26 “Arsimi dhe kultura”,
8. Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 13, datë 30.6.2023, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të njëvlershmerisë së dëftesave dhe të diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Kapitulli 26 “Arsimi dhe kultura”,
9. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 123, datë 10.10.2023 “Për miratimin e rregullores “Mbi një metodë të përbashkët të sigurisë për vlerësimin e konformitetit me kërkesat për marrjen e autorizimit të sigurisë hekurudhore”, përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 “Transporti”,
10. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 119, datë 29.9.2023, “Për miratimin e rregullores “Mbi kuadrin rregullator për hapësirën –U të hapësirës ajrore”, përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 “Transporti”,
11. Vendim i Komisionit të Konkurrencës nr. 1043, datë 29.12.2023, “Mbi miratimin e Manualit të Procedurave të Sjelljeve Antikonkurrese”, përgatitur nga Autoriteti i Konkurrencës, Kapitulli 8 “Konkurrenca”,
12. Rregullore e AMF nr. 4, datë 26.01.2023 “Për formën dhe përmbajtjen e Prospektit që publikohet kur Titujt i ofrohen publikut dhe/ose pranohen për tregtim në një treg të rregulluar”, përgatitur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Kapitulli 9 “Shërbimet financiare”,
13. Rregullore e AMF nr. 5, datë 26.01.2023 “Për kërkesat e transparencës në lidhje me Informacionin e shoqërive të listuara”, përgatitur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Kapitulli 9 “Shërbimet financiare”,
14. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT datë 11.12.2023 “Për miratimin e udhëzimit “Për vrojtimit statistikore të qumështit dhe të nën-produkteve të tij”, përgatitur nga INSTAT, Kapitulli 18 “Statistikat”,
15. Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 25, datë 29.12.2023, “Për miratimin e rregullave të detajuara për regjistrat e hyrje daljeve”, përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 “Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve”,

16. Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 11, datë 2.5.2023 "Mbi materialet dhe artikujt aktivë dhe inteligjentë në kontakt me ushqimin", përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 "Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve",
17. Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 15, datë 15.6.2023 "Mbi përcaktimin e kriterëve dalluese mes ushqimit për kafshë, aditivëve ushqimorë për ushqime për kafshë, produkteve biocide dhe produkteve mjekësore veterinarë", përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 "Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve",
18. Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 16, datë 20.12.2023, "Për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 "Transporti",
19. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 169, datë 13.12.2023, "Për miratimin e rregullores "Për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për sipërmarrjet hekurudhore", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 "Transporti",
20. Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 15, datë 14.12.2023, "Për shërbimet publike të transportit hekurudhor të udhëtarëve", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 "Transporti",
21. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 170, datë 13.12.2023, "Për miratimin e rregullores "Mbi një metodë të përbashkët sigurie për monitorimin që zbatohet nga sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, pas marrjes së certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 "Transporti",
22. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 167, datë 13.12.2023 "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e disa aspekteve të procedurës së licencimit të sipërmarrjeve hekurudhore", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 "Transporti",
23. Urdhër i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 178, datë 20.12.2023, "Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative lidhur me personelin ajror te aviacionit civil", përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kapitulli 14 "Transporti",
24. Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 705, datë 18.12.2023 "Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë 2024-2027", përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore",
25. Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 44, datë 4.10.2023 "Për miratimin e rregullores "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për prona të paluajtshme", përgatitur nga Banka e Shqipërisë, Kapitulli 9 "Shërbimet financiare",
26. Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 17, datë 14.07.2023, "Mbi kushtet specifike dhe procedurat e detajuara për importin e materialeve në kontakt me ushqimin, enëve plastike të kuzhinës, poliamide dhe melamine, me origjinë ose të dërguara nga Republika Popullore e Kinës dhe Hong Kongu", përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 "Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve",
27. Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 19, datë 2.08.2023, "Mbi vendosjen e rregullave specifike për kontrollin zyrtar të Trikinelës në mish", përgatitur

- nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 “Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve”,
28. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 274, datë 5.5.2023, “Për procedurën, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë një operator për t’u miratuar për lëshimin e pasaportës bimë, si dhe rastet e heqjes së miratimit”, përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 “Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve”,
  29. Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 9, datë 28.4.2023, “Për kriteret teknike të mjeteve dhe makinerive, të cilat përdoren për trajtimet me produkte të mbrojtjes së bimëve”, përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 12 “Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe shëndetit të bimëve”,
  30. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 230 datë 13.04.2023, “Për disa shtesa në urdhrin nr. 149, datë 31.3.2022, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kapitulli 13 “Peshkimi”,
  31. Rregullore e AMF nr. 6, datë 26.01.2023 “Për Mjaftueshmërinë e Kapitalit të Shoqërisë Komisionere”, përgatitur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Kapitulli 9 “Shërbimet financiare”,
  32. Vendim i Autoritetit të Konkurrencës nr. 1040, datë 22.12.2023, “Për miratimin e udhëzuesit “Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacionit në bazat e të dhënave, gjatë procedurave hetimore dhe të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës””, përgatitur nga Autoriteti i Konkurrencës, Kapitulli 8 “Konkurrenca”,
  33. Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT datë 11.12.2023 “Për miratimin e udhëzimit “Për zbatimin e parimeve për matjen e çmimeve dhe vëllimeve në llogaritë kombëtare”, përgatitur nga INSTAT, Kapitulli 18 “Statistikat”.

**30 aktet e riplanifikuara në PKIE 2023 - 2025, 24 janë për miratim në vitin 2024 dhe 2025, si pjesë e PKIE 2024 – 2026; 2 akte të planifikuara si të ndarë në 2023-shin do të miratohen si një akt i vetëm në 2024; ndërkohë 5 akte janë në proces rivlerësimi mbi nevojën e përafrimit të tyre.**

Për të gjitha 24 aktet e riplanifikuara në PKIE 2024 – 2026, ka nisur puna për hartimin e tyre gjatë vitit 2023, dhe sipas shkallës aktuale të përgatitjes:

- 11 akte janë në procedurë të avancuar miratimi.
- 9 akte janë në fazë të avancuar hartimi,

Puna me PKIE tregon nevojën për forcimin e kapaciteteve, hartimin e projekteve me grupe pune dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstucional, si dhe forcimin e kapaciteteve për njohjen e *acquis* së Bashkimit Evropian dhe hartimin e legjislacionit të përafruar, si një nga prioritetet e të gjitha ministrive dhe institucioneve, masa të cilat parashikohen në buxhetin 2024, PKIE 2024-2026 & IPA 2022, etj.

## **PJESA III: MENAXHIMI I FONDEVE NGA BASHKIMI EVROPIAN DHE DONATORËT E TJERË**

Gjatë perspektivës financiare IPA III (2021-2027), Shqipëria përfiton nga një sërë instrumentesh financimit të Bashkimit Evropian. Në mënyrë të përmblodhur, këto instrumente mund të grupohen si më poshtë vijon:

- a) Programet Kombëtare të Veprimit (IPA Kombëtare);
- b) Instrumentet rajonale: IPA me shumë-vende përfitues, WBIF;
- c) Programet e Unionit;
- d) Programet e Bashkëpunimit Territorial;
- e) Interreg.

### 3.1 Procesi i programimit IPA Kombëtare.

Referuar periudhës raportuese janar-dhjetor 2023, koordinimi për këto programe kryhet nga zyra e Koordinatorit Kombëtar IPA (NIPAC).

#### I. Programimi në kuadër të IPA III

#### Marrëveshja Financiare për Programin Kombëtar IPA 2022

Marrëveshja Financiare IPA 2022 ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2022, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA III), është miratuar në parim me VKM nr. 87, datë 22.02.2023 dhe më tej janë ndjekur hapat ligjorë për miratimin e plotë, që u finalizuan me VKM nr. 165, datë 24.03.2023. Paketa e dokumenteve të IPA 2022 i kushton vëmendje të veçantë fushave kryesore të kriterëve të anëtarësimit politik, të evidentuara edhe në Konferencën e Parë Ndërqeveritare me Bashkimin Evropian, e mbajtur më 19 korrik 2022, duke përfshirë zbatimin e ligjit, të drejtat themelore, mbështetjes për procesin e integritit evropian, agjendën e gjelbër, etj. Për më tepër, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe kontributit në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Dokumentet e veprimit, pjesë e IPA 2022 janë:

1. **BE për Zbatimin e Ligjit;**
  - Buxheti i BE: 14.9 milionë €.
  - Përfitues: Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.
  - Objektivi i përgjithshëm i tij është të forcojë më tej kapacitetet e autoriteteve shqiptare për zbatimin e strategjive kombëtare që synojnë luftën e krimin të organizuar dhe migracionit të parregullt.
  - Modaliteti i zbatimit: Menaxhimi indirekt.
2. **“Mbështetje për procesin e rivlerësimit të përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri – IMO Faza III”;**
  - Buxheti i BE: 9.7 €.

- Përfitues: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), Dhoma e Apelit dhe Komisionerët Publikë (KP).
- Objektivi i përgjithshëm është të mbështesë Shqipërinë në forcimin e pavarësisë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë shqiptare.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhimi indirekt me Agjencinë Austriake për Zhvillim

3. "BE për Demokracinë";

- Buxheti i BE: 5 milionë €.
- Përfitues: Kuvendi i Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
- Objektivi i Përgjithshëm është të forcojë pjesëmarrjen demokratike dhe besimin e qytetarëve shqiptarë në institucionet përkatëse publike në kuadër të anëtarësimit në BE.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhimi direkt.

4. "BE për Ujin";

- Buxheti i BE: 29 milionë €.
- Përfitues: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Dokumenti i Veprimi bazohet në programet e ujit IPA 2016 dhe IPA 2018 të financuara nga IPA II, të cilat mbështesin menaxhimin e integruar të ujit dhe reduktimin e ndotjes së ujërave të zeza në Shqipëri.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhimi indirekt me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA), Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe me subjektin që do të zgjidhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në seksionin 4.3.1 të tij.

5. "Instrumenti Lehtësues për Integrimin Evropian" (EIF);

- Buxheti i BE: 19 milionë €.
- Përfitues: SASPAC, MFE, ZK, CFCU, KM, Njësitë IPA, MIE, MBZHR, QKB, ARRSH, Hekurudhat Shqiptare, Agjencia e Eficiencës së Energjisë.
- Objektivi i përgjithshëm është të sjellë politikat dhe legjislacionin e Shqipërisë në përputhje me politikat e BE-së dhe *acquis*-në e BE-së dhe të ndërtojë kapacitete administrative për zbatimin e plotë dhe efektiv të politikave dhe legjislacionit sektorial të miratuar. Objektivi specifik i veprimit është progresi i arritur në përafrimin e legjislacionit *me acquis* të BE-së (përfshirë dispozitat e barazisë gjinore) dhe kapacitetet e ndërtuara për zbatimin e tij në sektorët hekurudhor, detar, energjetik, lidhjes digjitale dhe bujqësisë.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhimi indirekt

6. "BE për Rininë".

- Buxheti i BE: 5 milionë €.
- Përfitues: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.
- Objektivi i përgjithshëm i veprimit është të kontribuojë në pjesëmarrjen politike, ekonomike dhe sociale të të rinjve në shoqëri përmes rritjes së punësimit cilësor dhe qytetarisë rinore aktive.

## Raport për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

- Modaliteti i zbatimit: Menaxhimi indirekt me subjektin (subjektet) që do të zgjidhen në përputhje me kriteret e përcaktuara në seksionin 4.3.1..

### Marrëveshja Financiare për Programin Kombëtar IPA 2023

Marrëveshja Financiare IPA 2023 ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2023, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA III) u miratua në parim me VKM nr. 103, datë 01.03.2023 dhe më tej janë ndjekur hapat ligjorë për miratimin e plotë që u finalizua me VKM Nr. 166, datë 24.03.2023.

Programi IPA 2023 i kushton vëmendje të veçantë Ndërtimit të Shtetit dhe Rezistencës për të zbutur ndikimin e menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike dhe për të krijuar bazën për ndërtimin e rezistencës energjetike në Shqipëri. Programi vjetor kombëtar, që kontribuon në Paketën e Mbështetjes Energjetike të Ballkanit Perëndimor në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2023, do të mbështesë Veprimin: Kontrata e Ndërtimit të Shtetit dhe Rezistencës për Shqipërinë.

Dritarja 3: Agjenda e Gjellbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme Prioriteti Tematik 2: Transporti, ekonomia dhe shoqëria digjitale, si dhe energjia (60%).

Dritarja 4 – Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse Prioriteti Tematik 1: Arsimi, punësimi, politikat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, si dhe shëndeti (20%) Prioriteti Tematik 2: Zhvillimi i sektorit privat, tregtisë, kërkimit shkencor dhe novacionit (20%).

Buxheti: 80 milionë euro

Përfitues: MIE, MFE, MSHMS

Objekti i përgjithshëm i këtij veprimi është të ndihmojë Shqipërinë me politika/masa të synuara të rritjes ekonomike, të cilat synojnë të zbusin efektet socio-ekonomike të krizës energjetike, veçanërisht në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe familjet, si dhe të forcojë kapacitetin e përgjithshëm të qeverisë për të ndërmarrë masa që reduktojnë gjasat e varfërisë energjetike, veçanërisht të kategorive më të cënueshme të popullsisë, si dhe për të mbështetur rimëkëmbjen afatgjatë socio-ekonomike, sigurinë energjetike, dhe diversifikimin e sistemeve të energjisë së rinovueshme në Shqipëri.

### Programimi i Programit Kombëtar IPA 2024

Në datën 29 Shtator 2023, Komisioni Evropian, me anë të shkresës Ref.Ares (2023) 6604149, përcolli pranë KKIPA vlerësimin e maturitetit për dokumentet e veprimit të paketës IPA 2024, me qëllim reflektimin e komenteve të DG NEAR dhe përcjelljen e paketës finale pranë Komisionit brenda afatit të caktuar nga ky i fundit. Si rrjedhojë, ZM KKIPA në koordinim me institucionet përfituese punuan gjatë muajit tetor për hartimin e dokumenteve finale dhe i përcollën ato pranë Komisionit Evropian në datën 8 nëntor 2023. 5 Dokumentet e Veprimit që do të financohen nga programi kombëtar IPA 2024 në vlerën totale (67.35 milionë euro) janë si më poshtë:

1. Lufta kundër Korrupsionit;
  - Buxheti i BE: 3.85 Milionë Euro.



- Përfitues: Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion.
- Objektivi i përgjithshëm i dokumentit të veprimit është të ndihmojë në uljen e korrupsionit në Shqipëri nëpërmjet parandalimit, represionit dhe ndërgjegjësimit.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhim direkt nëpërmjet prokurimit për asistencë teknike Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion.

## 2. BE për Qeverisjen Vendore;

- Buxheti i BE:10 milionë €.
- Përfitues: Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.
- Objektivi i përgjithshëm i këtij dokumenti veprimi është kontributi në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe zhvillimin ekonomik lokal.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhim indirekt me një entitet të besuar.

## 3. BE për Pyjet;

- Buxheti i BE:13 milionë €.
- Përfitues: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Objektivi i përgjithshëm i këtij dokumenti veprimi është përmirësimi i cilësisë së mbrojtjes së mjedisit dhe kontributi në veprimet dhe politikat kundër ndryshimeve klimatike për të përshpejtuar kalimin drejt një ekonomie me karbon të ulët.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhim indirekt me një entitet të besuar.

## 4. BE për Sigurinë Ushqimore;

- Buxheti i BE:12.5 milionë €.
- Përfitues: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Qëllimi i dokumentit të veprimit është të mbështesë institucionet shqiptare në përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së dhe praktikave më të mira në fushën e sigurisë ushqimore, politikës veterinarë dhe fitosanitare, e cila u bë gjithnjë e më e rëndësishme pas hapjes së negociatave të anëtarësimit në 2022.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhim indirekt me një entitet të besuar.

## 5. Mbështetja buxhetore sektoriale “BE për Punësimin dhe Përfshirjen Sociale”.

- Buxheti i BE:28 milionë €.
- Përfitues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- Dokumenti i Veprimit synon të ofrojë mbështetje për prioritetet e qeverisë drejt avancimit të politikave të tregut të punës dhe reformave të mirëqenies sociale që nxisin mundësi të barabarta, punë të denjë dhe mirëqenie të popullatës. Objektivi kryesor është të zgjerojë mbulimin, gjithë përfshirjen, efektivitetin dhe reagimin ndaj goditjeve të masave të mbrojtjes sociale dhe tregut të punës, duke përfshirë kategoritë në rrezik përjashtimi.
- Modaliteti i zbatimit: Menaxhim direkt nëpërmjet mbështetjes buxhetore dhe prokurimit.

## Programet Operacionale 2024-2027.

Njëkohësisht me përgatitjen e paketës IPA 2024, institucionet shqiptare, të koordinuara nga KKIPA/ZM KKIPA, nisën procesin e hartimit të 3 Programeve Operacionale për periudhën 2024-2027 me vlerë totale indikative 186.48 milionë Euro (130 milionë Euro kontribut i BE-së dhe



56.48 milionë Euro bashkëfinancim i yni), angazhimi i qeverisë shqiptare me mbi 30 % duke tejkaluar minimumin e kërkuar prej 15 % nga BE.

Në 29 Shtator 2023, me shkresën Ref.Ares(2023)6604149, Komisioni Evropian përçolli pranë KKIPA Programet Operacionale me komente pas rishikimit të cilësisë dhe pas punës një mujore të përfituesve nën koordinimin e ZM KKIPA, në datën 6 nëntor 2023 u përçoll pranë Komisionit Evropian paketa finale me 3 Programet Operacionale dhe 7 Dokumentet e Identifikimit të Veprimeve (OIS) për miratim nga zyrat përgjegjëse në Bruksel.

Programet Operacionale do të fokusohen në reformat dhe përmirësimin e politikave, si: digjitalizimi me qëllim automatizimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe bizneseve si dhe veprimtarisë së administratës publike, eficaenca energjisë si dhe punësimi, arsimimi dhe aftësitë e të rinjve. Programet operacionale (2024-2027) janë si më poshtë:

1. Programi Operacional **për Ekonominë dhe Shoqërinë Digjitale** (44 milionë € ku 30 milionë € janë kontribut i BE), nëpërmjet të cilitsynohet të arrihen objektiva të modernizimit dhe konsolidimit të infrastrukturës digjitale dhe angazhimin që Shqipëria 2030 të jetë e digjitalizuar në të mirë të qytetarëve, sipërmarrjes dhe brezit të ri. Synohet përmirësimi dhe modernizimi i sistemeve elektronike në të gjithë sektorët, me qëllim automatizimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe bizneseve të tyre, si dhe veprimtarisë së administratës publike.
2. Programi Operacional **për Energjinë** (79 milionë €, ku 50 milionë € janë kontribut i BE-së), që do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe uljen e konsumit të energjisë, përmes aktiviteteve të Auditimit të Energjisë dhe zbatimit të masave të eficaencës së energjisë në ndërtesat publike, përmes aktiviteteve të vlerësimit të energjisë dhe zbatimit të masave të eficaencës së energjisë në sektorin e furnizimit me ujë, në e-mobilitetin përmes investimeve për instalimin e stacioneve të karikimit të makinave elektrike dhe instalimin e paneleve fotovoltaike. Fokusi i veçantë në elektrifikimin e hekurudhave si një mënyrë transporti miqësore me mjedisin.
3. Programi Operacional **për Punësimin e të rinjve** (63.48 milionë €, ku 50 milionë € janë kontribut i BE-së), përmes të cilit Qeveria Shqiptare synon të arrijë objektivat kryesore në lidhje me punësimin, arsimimin dhe aftësitë e të rinjve, pjesëmarrjen dhe zhvillimin. Programi operacional do të mbështesë fazën e hapjes së Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore.

Njëkohësisht me përgatitjen e OP-ve, Komisioni i ka kërkuar përfituesve që të përgatisin edhe dokumentet e identifikimit të veprimeve për vitin e parë të zbatimit të programeve operacionale, si më poshtë, të cilat u përçollën pranë Komisionit së bashku me OP-të e finalizuara.

#### **7 Dokumentet e Identifikimit të Veprimeve si më poshtë:**

- i. Forcimi i kapaciteteve të Autoritetit Menaxhues, Organeve të Ndërmjetme, Partnerëve të Programit dhe përfituesve përfundimtarë për zbatimin efektiv të kontrollit, monitorimit dhe vlerësimit të Programit Operacional për Energjinë 2024-2027;
- ii. Masat e eficaencës së energjisë për ndërtesat publike lokale në bashkitë në Shqipëri;
- iii. Forcimi i ndërgjegjësimit kibernetik, aftësisë për analiza parandaluese dhe rimëkëmbjes kibernetike dhe reagimit të organizatave të sektorit publik, për të përmirësuar aftësinë e autoriteteve shqiptare për t'u mbrojtur kundër kërcënimeve kibernetike;

- iv. Forcimi i lidhjes digjitale dhe transformimi digjital i bizneseve dhe shërbimeve publike mund të përdoret për inovacione që krijojnë pasuri për shoqëritë dhe bizneset;
- v. Forcimi i kapaciteteve të Autoritetit Menaxhues, Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar, Partnerëve të Programit dhe përfituesve përfundimtarë për të siguruar zbatimin, kontrollin, monitorimin dhe vlerësimin efektiv të Programit Operacional Ekonomia dhe Shoqëria Digjitale 2024-2027;
- vi. Rritja e mundësive të punësimit të të rinjve nëpërmjet Zbatimit të Garancisë së Përforcuar për Rininë në Shqipëri;
- vii. Forcimi i kapaciteteve të Autoritetit Menaxhues, Organeve të Ndërmjetme dhe Partnerëve të Programit për të siguruar zbatimin, kontrollin, monitorimin dhe vlerësimin efektiv të Programit Operacional “BE për Punësimin e të Rinjve” 2024 – 2027.

## II. Mbi ecurinë e projekteve të financuara nga IPA Kombëtare

Monitorimi i Asistencës financiare IPA, përfshirë funksionin e raportimit, koordinohet nga Zyra Mbështetëse KKIPA në partneritet me institucionet, strukturat dhe autoritetet e tjera me kompetenca monitoruese si, Komisioni Evropian dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Zyrtari Kombëtar Autorizues – ZKA (Zyra Mbështetëse e ZKA dhe Fondi Kombëtar); Drejtoria e Financimeve dhe Kontraktiveve (CFCU); Strukturat përgjegjëse/njësitë për menaxhimin e programeve IPA, në ministritë e linjës dhe/ose në institucionet përfituese, Autoriteti i Auditit.

Instrumentet me anë të së cilave kryhet procesi i monitorimit të zbatimit të fondeve IPA janë, Komiteti Monitorues i IPA-s dhe Komitetet Sektoriale të Monitorimit të IPA-s si dhe Komitetet Drejtuese në nivel projekti, të cilat përpos të gjithë aktorëve të mësipërm mund të përfshijnë aktorë të tjerë kyç që lidhen me asistencën IPA.

**Në kuadër të IPA II (2014–2020) janë miratuar gjithsej (9) mbështetje buxhetore me buxhet total 272.2 milionë €, ndërsa nën IPA III (2021 – 2027) është miratuar (1) mbështetje buxhetore deri më tani, me buxhet total 80 milionë euro.**

Përsa më sipër aktualisht në zbatim janë 4 kontrata të Mbështetjes Buxhetore me një buxhet të miratuar prej 226,650,000 €. Për kontratat në zbatim, deri më dhjetor 2023 janë disbursuar 169,354,779 euro, ose rreth 75% e buxhetit të miratuar, përfshirë, shumat e mbartura <sup>23</sup> për kërkesat për vitet 2021-2022.

### **Risi në zbatimin e projekteve IPA**

Nisur nga të gjitha sfidat e evidentuara ndër vite në zbatimin me sukses të projekteve IPA dhe përthithjen e fondeve të vëna në dispozicion për Shqipërinë, në 2021, u vendos për herë të parë një fond i dedikuar në buxhetin e shtetit, me anë të të cilit mundësohet mbështetja

---

<sup>23</sup> SipaskonfirmimevetëDelegacionittë BE-sënëTiranëMinistrisë e Financave dhe Ekonomisë përdisbursimin e shumat e mbarturavitit 2021-2022.

financiare e të gjithë institucioneve publike qendrore dhe vendore, për para-financimin, bashkëfinancimin dhe pagesën e TVSH dhe të detyrimeve doganore.

Akti normativ i Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 1.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, përcaktoi fondin limit 360,000,000 Lekë.

Për vitin 2023, bazuar në ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, neni 11, paragrafi i fundit, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, shtojca B,: Neni 11, rishikuar me Aktin e Normativ nr.5 datë 18.10.2023 përcakton fondin prej 250 milionë lekësh, në programin buxhetor “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Nga 1 janar 2023**, sipas ligjit nr.82/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, TVSH-ja trajtohet si furnizim i ngjashëm me eksportet, furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime. Për të siguruar trajtimin dhe përjashtimin nga TVSH-ja është miratuar udhëzimi nr. 27, datë 13.9.2023 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë i cili jep udhëzime mbi procedurën që zbatuesit ose përfituesit e projekteve të financuara me fonde të huaj duhet të ndjekin për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së zero për qind. Sipas këtij udhëzimi, regjistrimi i programit/projektit bëhet pranë SASPAC, i cili sipas parashikimeve të ligjit dhe udhëzimeve në fuqi lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Programit/Projektit duke i pajisur me një kod unik.

### 3.2 Programimi dhe Monitorimi i IPA Rajonale

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2023, lidhur me mbështetjen që Shqipëria përfiton nga asistenca e Bashkimit Evropian nëpërmjet instrumenteve të shtrirje dhe fokus rajonal, janë koordinuar dhe ndjekur proceset kryesore, ndarë sipas instrumenteve si më poshtë vijon, dhe janë arritur rezultatet përkatëse në terma projektsh/programesh dhe vlera grantesh të miratuara si dhe aspekte të tjera të lidhura.

#### Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF)

Në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë nën WBIF, gjatë vitit 2023, Shqipëria ka marrë pjesë, nëpërmjet aplikimit të projekteve, në dy thirrje për grant investimi, përkatësisht thirrja e 8<sup>të</sup> dhe e 9<sup>të</sup>, dhe në një thirrje për grante që mbështesin veprimtari të asistencës teknike për përgatitjen dhe maturimin e projekteve, thirrja e 29<sup>të</sup>. Për trajtimin dhe miratimin e projekteve të aplikuara në këto thirrje janë mbajtur dy takime të Bordit Operacional të WBIF.

Bazuar në vendimmarrjen e Bordit Operacional për Shqipërinë u miratua mbështetja me grant investimi për projektin “*Transporti i Gjelbër në qytetin e Tiranës*”. Ky projekt synon të sigurojë një pjesë të konsiderueshme të kërkesës në rritje të kryeqytetit për lëvizshmëri, përmes një transporti publik të qëndrueshëm, të gjelbër, të sigurt, të rehatshëm dhe të aksesueshëm, duke rritur kështu cilësinë e shërbimit dhe reduktuar nivelin e ndotjes nga emetimet e CO<sub>2</sub>. Granti, i cili do të jepet nga BE për këtë projekt, është në vlerën e 31 milionë Euro, e cila përbën rreth

30% të kostos totale të projektit prej 110.3 milionë Euro. Pjesa tjetër financohet nga hua prej KfW dhe buxheti i shtetit.

Krahas projektit të investimit, u miratuan edhe 3 (tre) projekt-propozime për marrjen e asistencës teknike:

- *Ndërtimi i një linje të re interkonjeksiioni 400kV Shqipëri (Fier) – Greqi (Araktos) – Studim Fizibiliteti dhe VNMS*, me një grant prej 1.1 milionë Euro dhe nën drejtimin e KfW, në rolin e institucionit financiar ndërkombëtar;
- *Ndërtimi i centraleve eolike në det – Projektimi konceptual, Studim Fizibiliteti dhe VNMS*, me grant prej 2 milionë Euro dhe nën drejtimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në rolin e institucionit financiar ndërkombëtar;
- *Strategjia e Integruar Kombëtare e Sanitetit të Ujit të Pijshëm dhe Planifikimi i Investimeve*, me grant prej 1.2 milionë Euro dhe nën drejtimin e Bankës Botërore, në rolin e institucionit financiar ndërkombëtar.

Në takmin e dytë të Bordit për vitin 2023, mbajtur më 8 dhjetor, u miratua mbështetja me grant investimi për projektin infrastrukturor *“Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë”* dhe projektin për energjinë e rinovueshme *“Ndërtimi i Impiantit Fotovoltaik 50 Mwp në Belsh”*.

Projekti për rehabilitimin e hekurudhës Durrës-Rrogozhinë është i një rëndësie të madhe për vendin dhe përbën fazën e parë të rindërtimit të infrastrukturës hekurudhore të Korridorit VIII. Vlera e grantit nga BE për këtë projekt do të jetë 60.4 milionë Euro, e cila përbën 50% të kostos totale të projektit. Pjesa tjetër do të mbështetet me financim nëpërmjet huasë nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI).

Ndërtimi i impiantit fotovoltaik në Belsh pritet të rrisë më tej kapacitetet prodhuese dhe të avancojë procesin e tranzicionit energjitik drejt energjisë së rinovueshme, në përputhje të plotë me Agjendën e Gjelbër dhe angazhimet, strategjitë dhe prioritetet kryesore të vendit. Projekti, me një kosto totale prej 41.4 milionë Euro, do të mbështetet me grant në vlerën e 9.2 milionë Euro. Pjesa tjetër e kostove do të mbulohet nga financimi me kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe buxheti i shtetit.

WBIF ka njoftuar tashmë edhe hapjen e thirrjeve të reja për grant të investimit dhe asistencës teknike për sektorin publik, përkatësisht thirrja e 10<sup>të</sup> për projekte investimi si dhe thirrja e 30<sup>të</sup> për veprimtari të asistencës teknike. Ka nisur puna koordinuese me institucionet shqiptare dhe institucionet financiare ndërkombëtare për përgatitjen për aplikimet e projekt-propozimeve në këto thirrje. Ky proces do të jetë i linjësuar me procesin e vlerësimit dhe planifikimin që është në vijim, sa i përket drejtimin të WBIF në kuadër të Planit të Ri të Rritjes.

### **IPA me Shumë Vende Përfituese**

Sa i përket programit të *IPA me Shumë Vende Përfituese*, në muajin qershor Komisioni Evropian ka ndarë me vendet përfituese listën indikativetë dokumenteve të veprimit, pjesë e Planit të Veprimit për vitin 2024. KKIPA, në përmbushje të detyrave koordinuese, ka kërkuar nga institucionet përfituese të reflektojnë komentet dhe propozimet e tyre në këto dokumente veprimi dhe pas këtij procesi konsultues ka përcjellë në drejtim të Komisionit Evropian

dokumentet e rishikuara me reflektimet e institucioneve shqiptare. Dokumentet e Veprimit pritet të prezantohen në Komitetin e IPAs dhe të kalohen më pas për miratim nga Komisioni.

### Programe të Bashkëpunimit Territorial & Interreg

ZK KKIPA, në cilësinë e Strukturës Operuese, ka vijuar punën për zbatimin e 8 programeve që zbatohen nën perspektivën financiare IPA II 2014 – 2020 dhe 9 programeve të tjera për periudhën IPA III 2021-2027.

Gjatë periudhës financiare 2021-2027, përveç programeve që janë zbatuar në periudhën 2014-2020 (me përjashtim të Programit Interreg Balkanmed që nuk do të zbatohet në periudhën IPA III), vendi ynë do të marrë pjesë edhe në 2 programe të reja, konkretisht, *Interreg EUROPE* dhe *Interreg URBACT*.

Në kuadër të Programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri, më dt. 2 mars 2023 u organizua Ceremonia e Akordimit të Granteve për projektet e thirrjes së tretë për projekt-propozime gjatë të cilës rezultuan fitues 6 projekte (me vlerë 2.120.309,76 EUR për partnerët shqiptarë dhe malazezë) nga të cilat 2 prej tyre janë me partner drejtues (Lead Partner) shqiptar. Këto projekte filluan zbatimin e tyre gjatë periudhës mars-prill 2023 dhe kanë një afat zbatimi 18-24 muaj.

Më 17 mars 2023 u shpall thirrja e katërt dhe e fundit për projekt-propozime për këtë periudhë financiare. Për thirrjen e katërt për projekt-propozime të shpallur më 17 mars 2023, ende nuk përfunduar procesi i vlerësimit të aplikimeve. Ky proces pritet të përfundojë gjatë muajit janar 2024 dhe kontratat me përfituesit e projekteve parashikohen të lidhen gjatë muajit shkurt 2024.

Në kuadër të zbatimit të programit Balkanmed, gjatë vitit 2023 nuk është organizuar ndonjë aktivitet pasi ky Program është në fazën e mbylljes dhe të gjithë projektet kanë përfunduar zbatimin (me përjashtim të 1 projekti i cili është ende në zbatim). Në kuadër të mbylljes së këtij Programi, më 20.11.2023 në Selanik u organizua Konferenca përmbyllëse ku u prezantuan të gjitha arritjet e Programit. Më datë 22 dhjetor 2023, u organizua online, takimi i fundit i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit. Në këtë takim u paraqit një raport përfundimtar për të gjithë periudhën e zbatimit të programit, në lidhje me problematikat, projektet e suksesshme, rezultatet e arritura, etj.

Në kuadër të zbatimit të Programit Interreg IPA BNK Greqi-Shqipëri, më dt. 4 prill 2023 u zhvillua takimi i 8 të Komitetit të Përbashkët Monitorues (JMC) të Programit 2014-2020 si dhe takimit të 1 të Komitetit të Përbashkët Monitorues të Programit 2021-2027. Në takimin e 8 të Komitetit të Përbashkët Monitorues të Programit 2014-2020 u prezantua situata e zbatimit të Programit aktual u miratua Plani Shumë-vjeçar i Asistencës Teknike dhe Planit Vjetor të Komunikimit për vitin 2023.

Gjatë kësaj periudhe është finalizuar procesi i miratimit në parim të Marrëveshjes së Financimit IPA III 2021-2027 nëpërmjet VKM nr. 523, datë 07.09.2023.

Në kuadër të zbatimit të Programit Shqipëri-Kosovë më datë 18 Korrik 2023 u zhvillua takimi i 9të i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit/JMC, i cili kishte si qëllim miratimin e projekteve të thirrjes së 4<sup>t</sup> për projekt propozime. Kjo thirrje u lancua më datë 20 shkurt 2023 dhe u mbyll më datë 22 maj 2023. Gjatë kësaj periudhe është finalizuar procesi i miratimit në parim të Marrëveshjes së Financimit IPA III 2021-2027 nëpërmjet VKM nr. 559, datë 04.10.2023.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023 janë realizuar aktivitete të ndryshme në kuadër të implementimit të këtij programi si: sesione informuese (mars 2023), vizita monitoruese (prill dhe nëntor 2023), trajnime për përfituesit (korrik dhe nëntor 2023) si dhe evente vizibiliteti në qytetin e Bajram Currit (25 shtator 2023) dhe në qytetin e Tiranës (1 nëntor 2023).

Në kuadër të zbatimit të programit Itali-Shqipëri-Mali i Zi/Adriatiku Jugor gjatë vitit 2023 u zhvilluan 2 (dy) takime të Komitetit të Monitorimit përkatësisht: më datë 19 dhe 20 prill 2023 në Kolashin u zhvillua takimi i 15<sup>të</sup> i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit/JMC dhe takimi i 2<sup>të</sup> i Komitetit të Monitorimit/MC dhe më datë 19 dhe 20 tetor 2023 në Shkodër u zhvillua takimi i 16<sup>të</sup> i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit/JMC dhe takimi i 3<sup>të</sup> i Komitetit të Monitorimit/MC. Gjatë kësaj periudhe është finalizuar procesi i miratimit në parim të Marrëveshjes së Financimit IPA III 2021-2027 nëpërmjet VKM nr. 560, datë 04.10.2023. Gjithashtu, janë miratuar projektet strategjike si dhe projektet e thirrjes së 1<sup>rë</sup> (*smallscale*) të cilat do të nisin zbatimin e tyre në fillim të vitit 2024.

Në kuadër të programit IPA BNK Maqedoni e Veriut – Shqipëri, përgjatë periudhës raportuese, Strukturat Operuese kanë vijuar me takimet teknike dy palësh ndërmjet Strukturave Operuese të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, në kuadër të vijimit të proceseve të zbatimit të programit dhe parashikimet e mundshme për aktivitete e reja përgjatë vitit 2023 dhe për përmbylljen e Periudhës Programore IPA II e për nisjen e Periudhës së re IPA III. Në 10 nëntor 2023, në kuadër të programit të ri, u organizua Takimi i 1-rë i Komitetit të Përbashkët i Monitorimit, për të cilat diskutuan dhe u miratuan rregullat dhe procedurat, manualët e zbatimit për programin, planifikimin e aktiviteteve, etj. Në këtë takim u diskutuan ecuria e projekteve që janë në zbatim dhe termat për projektet e reja që do të financohen nën periudhën IPA III.

Nën programin IPA BNK Maqedoni e Veriut - Shqipëri, u zhvilluan vizita monitoruese në datat 20-23 dhe 28-30 mars 2023, për ecurinë e zbatimit të projekteve nga thirrja e 3-të e këtij programi, për vijimësinë e zbatimit të programeve.

Në shtator të 2023, u miratua në parim, Marrëveshja e Financimit ndërmjet vendeve Maqedoni e Veriut, Shqipërisë dhe Komisionit Evropian. Ajo u nënshkruar në Dhjetor 2023, nga Koordinatorin Kombëtar IPA.

Në kuadër të programit të ri Interreg URBACT, Shqipëria është përfshirë në programin e ri në fund të vitit 2022. Ky program ka një qasje gjithëpërfshirëse në hartimin dhe integrimin në politikbërjen e standardeve sipas modeleve evropiane në përfaqësimin e sfidave që hasin qyteti/et, metropoli/et. etj. Në këtë program, përfshihen të gjitha qytetet e Bashkimit Evropian, të Zvicrës, të Norvegjisë dhe të pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor (BH, MNE, RS, MK, AL). Nëpërmjet këtij programi, qytetet shqiptare do të kenë mundësinë të ndërveprojnë me qytete të tjera të përfshira në program duke iu qasur sfidave dhe duke krijuar rrjete për shkëmbimin e përvojave të ndryshme në standardet e qyteteve evropiane.

Ky program hapi thirrjen e parë për “Rrjetet e Planeve të Veprimt” sipas *URBACT IV*, më 9 janar 2023 deri në 31 mars 2023. Për këtë thirrje u organizuan ditë informuese online, nga Sekretariati Teknik, për të gjithë të interesuarit përgjatë muajin nëntor 2023, Komisioni Evropian dhe Autoriteti Menaxhues përcollën marrëveshjen e financimit për programin e bashkëpunimit ndërkuftar, *Interreg URBACT IV*, e cila u miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave dhe u nënshkrua nga Koordinatorin Kombëtar i IPA-ve në fund të Dhjetorit 2023.

Programi Interreg IPA ADRION 2021 – 2027: përgjatë periudhës raportuese ka vijuar procesi i programimit. Në 28 shkurt dhe 1 mars 2023, u mbajt online takimi i 1-rë i Komitetit të Monitorimit për këtë program, ku u përcaktua plani i veprimit, rregullat dhe procedurat e komitetit si dhe kalendari i aktiviteteve të programit. Gjithashtu, me 24 mars 2023, u zhvillua online takimi i 2-të i Komitetit të Monitorimit, ku u hartuan kushtet për thirrjen e parë për projekt propozime.

Thirrja e Parë e programit IPA ADRION u hap më datë 4 prill 2023, e qëndroi e hapur deri më datë 30 qershor 2023. Shuma për këtë thirrje ishte rreth 65 milion Euro. Thirrja synonte projekte të cilat do të mbështeteshin në 3 prioritet kryesore të programit, si Inovacionit, Turizmi natyror dhe kulturor, mjedisi dhe ndryshimet klimatike dhe lidhshmëria në rajonin Adritiko-Jonian. Në kuadër të thirrjes, Shqipëria ishte e përfaqësuar në 217 projekte propozime paraprake, për të cilat janë kryer verifikimet dhe vlerësimet nga ekspertë ndërkombëtar.

Duke konsideruar se ky program mbështet edhe në Strategjinë Makro-Rajonale EUSAIR nën “Prioritetin 4 – Qeverisje e mire në rajonin Adriatiko-Jonian”, sipas dakordësisë edhe me Komisionin, shpërndarja e menaxhimit të kësaj strategjie do të jetë ndërmjet vendeve pjesëmarrëse. Strategjia, do të shpërndahet në tre projekte strategjike, ku Shqipëria do të marrë pjesë në dy prej tyre, Projekti 1 –EUSAIR FacilityPoint dhe Projektin 2 – Platforma e Palëve të Interesuara. Projektet janë dorëzuar me sukses pranë Autoritetit Menaxhues dhe ka vijuar më tej me vlerësimin e tyre me qëllim kontraktimin në fillimin të vitit 2024 për zhvillimin e Strategjisë.

Në kuadër të procesit të monitorimit, Agjencia Shtetërore e Programimi Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me përfituesit shqiptar që zbatojnë projekte në kuadër të programeve të bashkëpunimit territorial dhe ndër-rajonal me qëllim identifikimin e situatës së zbatimit të projekteve dhe nevojat e përfituesve, mbështetjen e tyre.

### **Strategjia e Bashkimit Evropian për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR)**

Shqipëria është pjesë e Strategjisë së Bashkimit Evropian për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR), bashkërisht me tetë vende të tjera të rajonit Adriatiko-Jonian. Strategjia funksionon mbi Planin e Veprimit të miratuar nga Komisioni Evropian në qershor 2014, e ka për qëllim kryesor nxitjen e rritjes ekonomike dhe mirëqenies në rajon duke u fokusuar në katër shtylla kryesore: zhvillimi blu, ndërlidhja e rajonit (transporti dhe energjia), mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm.

Nga 1 qershori 2023 deri më 31 maj 2024, Kroacia kryeson Nismën e Adriatikut dhe Jonit (IAE) dhe gjithashtu mban Presidencën e radhës për Strategjinë EUSAIR. Kjo presidencë fokusohet në disa fusha si rinia dhe gjithëpërfshirja, turizmi dhe kultura, promovimi i procesit të integritimit evropian tek të rinjtë dhe më gjerë për vendet e Ballkanit Perëndimor, digjitalizimi, rrjetet e ndërlidhjes, etj.

Në datat 23 – 25 maj 2023, në Sarajevë, u organizua Forumi i 8-të Ndërkombëtar në kuadër të Strategjisë EUSAIR nën presidencën e Shqipërisë. Ky forum pati një impakt të gjerë si në Shqipëri, ashtu edhe në të gjithë vendet e pjesëmarrëse nga rajoni.

Projekti i zhvillimit të kësaj strategjie, përmbylli në fund tetori 2023 periudhën e zbatimit përgjatë IPA II. Në periudhën e re IPA III, Shqipëria është sërish pjesë e Strategjisë së Bashkimit Evropian për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR), ku tashmë kësaj strategjie i janë bashkuar



edhe dy vende të reja, Maqedonia e Veriut dhe San Marino. Kjo strategji do të mbështetet nga programi i ri IPA ADRION dhe do të fokusohet në katër shtylla, Sh1- Zhvillimi blu, Sh2-Rritja e ndërlidhjes në rajon (transporti dhe energjia); Sh3-Zhvillimi dhe mbrojtja e mjedisit; Sh4-Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm.

Në shtator të 2023, vendet pjesëmarrëse kanë përfunduar me sukses hartimin e projekteve që do të mbështesin, zhvillimin e strategjisë. Strategjia do të vijojë të mbështete nga 3 projekte, ku Shqipëria është pjese e 2 prej tyre: Lehtësimi i Koordinatorëve të EUSAIR “EUSAIR Facility Point” dhe Platforma e angazhimit të Palëve të interesuara “StEP” .

### 3.3 Bashkëpunimi dhe dialogu me Donatorët e tjerë

Në kuadër të bashkëpunimit *dypalësh* gjatë vitit 2023 janë nënshkruar memorandume mirëkuptimi dhe bashkëpunimi:

- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet SASPAC dhe MASHAV- Agjencisë së Izraelit për Bashkëpunim për Zhvillim Ndërkombëtar, nënshkruar më 30 mars 2023;
- Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunimin e ndërsjellë midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës dhe Agjencisë Franceze të Zhvillimit, nënshkruar më 17 tetor 2023;
- u zhvilluan negociatat me palën turke për Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, mbi bashkëpunimin për zhvillim dhe statusin e Zyrës së Koordinimit të Programit TIKA në Shqipëri.

Gjatë 2023 vijoi zbatimi i protokollit të bashkëpunimit për zhvillim 2022-2023, nënshkruar me Republikën Federale të Gjermanisë në dhjetor 2022, në shumën 74,3 milion Euro. Programi përfshin mbështetje për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, formimin profesional, punësimin dhe klimën, energjinë dhe tranzicionin e drejtë.

Në zbatim të këtij protokollit, si dhe protokollit të bashkëpunimit për zhvillim të vitit 2020, u miratuan dhe nënshkruan marrëveshje financimi për projekte me GiZ dhe KfW, si më poshtë:

- Migracioni për zhvillim (PME III), me shumë 4,071,093 Euro (MFE);
- Marrëveshja e zbatimit për projekte të bashkëpunimit teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH përfaqësuar nga MBZHR dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë përfaqësuar nga GiZ, në shumën 7,500,000 mln Euro (MBZHR);
- Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri, në shumën 6,500,000 Euro (MTM);
- Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime të orientuara drejt Konsumatorit dhe Performancës (CPËS) dhe mbështetja e BE-së për Shërbimet e Menaxhimit dhe Trajtimit të Ujërave të Zeza, shtesë fondi 1,500,000 Euro;
- Marrëveshja e zbatimit nr. II për projektin Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Evropian në sektorin ekonomik (SANECA II), 1,500,000 Euro;
- Marrëveshja për projektin Bridge Component Albania (Ura Albania) në shumën 1,950,000 Euro;
- Marrëveshja për Bashkëpunim Teknik 2022 për projektin për një Zhvillim Urban Rezistent ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri me vlerë 3,000,000 Euro;



## *Raport për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë*

- Politikat për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik, Faza II, vlera e kredisë 50,000,000 Euro (MIE);
- Programi i performancës dhe investimeve në sektorin e ujit – pjesa II (Programi infrastruktura bashkiake V, pjesa e dytë) financuar me 50,000,000 Euro kredi dhe 3,000,000 Euro grant (MIE);
- Shtesë në Marrëveshjen e financimit të datës 28 maj 2018 për projektin Fondi për arsimin, aftësimin profesional dhe punësimin: Qendra multifunkionale e Kamzës, në shumën 2 milion Euro ;
- Marrëveshja shtesë e grantit për programin e rindërtimit të ndërtesave publike (faza I) në shumën 3,5 milion Euro (MIE, FSHZH);
- Marrëveshja e huasë për financimin e projektit Transporti i Gjelbër i Tiranës, në shumën 50,000,000 Euro (MIE).

**Me Zvicrën, në kuadrin e Programit të Bashkëpunimit 2022-2025** (me vlerë totale 103,400,000 CHF) u miratuan 5 projekte në fushën e kujdesit shëndetësor dhe edukimit qytetar si mbështetje për Komisionin qendror të zgjedhjeve:

- Risi/Inovacion Albania – faza III, shuma grant 6,900,290 CHF
- Marrëveshja për projektin Mbështetje ndaj parlamentit dhe edukimit qytetar: Mbështetje ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në shumën grant 1,2 milion CHF
- Mbështetje për gatishmërinë dhe reagimin ndaj urgjencave shëndetësore 5,300,000 CHF grant
- Shëndeti për të gjithë (HAP) 4,050,000 CHF grant
- Projekti Bashki të forta, faza II (2022-2026) në shumën 10 milion CHF.

**Bashkëpunimi me Italinë**, u fokusua në mbështetjen e projekteve për ekonominë blu, ngritjen e sistemit të mbrojtjes civile, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore dhe programi IADSA, si mbështetje për projekte në vlerë të vogël në fushën sociale për bashkitë e vendit:

- Programi Ekonomia Blu, vlera e kredisë 25,000,000 Euro (MBZHR);
- Mbështetje për ngritjen e sistemit të mbrojtjes civile në Shqipëri, vlera e kredisë 30,000,000 Euro;
- Përmirësimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipërinë veriore pas tërmetit të vitit 2019, vlera e kredisë 35,000,000 Euro.

**Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD)** bashkëfinancoi me Bankën Gjermane KfW projektin e mbështetjes buxhetore për politikat e mbështetjes së reformës në sektorin energjetik, Faza II, vlera e kredisë 50,000,000 Euro.

**Gjatë vitit 2023, Suedia** përgatiti një projekt të ri mbështetje për policinë e shtetit, i cili është ende në fazë elaborimi.

**Në kuadrin e bashkëpunimit me Japoninë**, përveç programeve të trajnimit të menaxhuara nga agjencia për zhvillim JICA, u dorëzuan aplikimet për asistencë teknike nga MBZHR për bashkëpunimin teknik për planifikim zhvillimi, nxitjen e kultivimit të qëndrueshëm në serra dhe zhvillimin e platformës ëebgis për menaxhimin e tokës.

**Bashkëpunimi me agjencitë ndërkombëtare për zhvillim**, gjatë periudhës së raportimit, u fokusua në koordinimin e programeve të trajnimit të ofruara kryesisht nga Qeveria Japoneze nëpërmjet Agjencisë Japoneze për Bashkëpunimet Ndërkombëtar (JICA), si dhe nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës (Agjencia Kineze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe nga Qeveria e Koresë, si më poshtë:

- Qeveria e Japonisë nëpërmjet (JICA) ka ofruar 12 programe trajnimi, nga të cilat janë përgjedhur 9 punonjës për të ndjekur këto programe (në Japoni dhe online) dhe dy Programe të Studimeve Zhvillimore “Rrjetet e Studimeve Bujqësore për Sigurinë Ushqimore-Agri-Net” dhe “Lider Global në OZHQ”, për të cilat janë nominuar dy aplikantë (në proces);
- Qeveria e Republikës Popullore të Kinës (Agjencia Kineze për Bashkëpunim Ndërkombëtar) ka ofruar 1 program trajnimi, i cili u koordinua me Ministrinë e Bujqësisë, Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Bashkinë Fier, Korçë, Berat, Lushnjë, Shkodër, nga i cili kanë realizuar trajnimin 17 punonjës.

**Bashkëpunimi me bankat zhvillimore** dhe institucionet financiare ndërkombëtare, përfshin realizimin e financimeve për projekte dhe programe me Bankën Botërore, BERZH, KFW, BEI, CEB etj.

- Me Bankën Botërore, puna u fokusua në mbështetjen e projektve në fushën e shërbimeve publike (GovTech), zhvillimin e bujqësisë dhe qëndrueshmërinë ndaj klimës, projektet për infrastrukturë si ai i ndërtimit të urave të qëndrueshme, mbështetje buxhetore, në kaudër të Strategjisë së Partneritetit me Shqipërinë 2023-2027:
- Hua për Politikën e Zhvillimit Aftësia e Parë Ripërtëritëse dhe Zhvillimi i Gjellbër”, MFE dhe IBRD, vlera e kredisë 110,800,000 Euro;
- Programi kombëtar i modernizimit të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, me IBRD, vlera e kredisë 75,000,000 USD, ratifikuar me ligjin nr.25/2023;
- Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë, vlera e kredisë 64,600,000 Euro;
- Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech, vlera e kredisë 60,000,000 Euro;
- Letërmarrëveshjet për financimin e projektit Mbështetje për Procesin e Integritetit të Industrive Nxjerrëse në Shqipëri, në shumën 700,000 USD;
- Marrëveshja e Huasë për projektin e ndërtimit të urave të qëndrueshme, duke përdorur qasjen e programit me shumë faza, në shumën 51,600,000 Euro.

Faleminderit!

Janar, 2024

**Majlinda  
Dhuka**



Digitally signed by Majlinda  
Dhuka  
Date: 2024.01.30 19:28:26  
+02'00'